



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

6866/6
Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 28.10.2025

URDHËR

Nr. 555, datë 28.10.2025

PËR

MIRATIMIN E PROGRAMEVE MËSIMORE TË DISA LËNDËVE TË
KURRIKULËS BËRTHAMË, TË DISA KLASAVE TË ARSIMIT BAZË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 45 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjave “dh” dhe “e”, të pikës 5, të kreut III, të vendimit nr. 98, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar” dhe të urdhrit nr. 497, datë 29.09.2025 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit znj. Orjana Osmani”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Gjuhë angleze”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Miratimin e “Programit mësimor të lëndës “Qytetari”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
3. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Matematikë”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
4. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Dituri natyre”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
5. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Edukim fizik, sport dhe shëndet”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 5, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

6. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Muzikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor", sipas shtojcës 6, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
7. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Art pamor", të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor", sipas shtojcës 7, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
8. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Teatër", të kurrikulës bërthamë, për klasën e pestë, klasën e gjashtë dhe klasën e shtatë të arsimit bazë", sipas shtojcës 8, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
9. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë shqipe", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 9, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
10. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë angleze", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 10, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
11. Miratimin e "Programit mësimor të lëndës "Qytetari", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 11, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
12. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Histori", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 12, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
13. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjeografi", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 13, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
14. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Matematikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 14, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
15. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Fizikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 15, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
16. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Biologji", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 16, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
17. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Edukim fizik, sport dhe shëndet", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 17, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
18. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë e huaj e dytë (frënge, italiane, gjermane), për shkollat me marrëveshje me ambasadat", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 18, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
19. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë e huaj e dytë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë dhe klasën e shtatë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 19, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

20. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Muzikë”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët”, sipas shtojcës 20, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
21. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Art pamor”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët”, sipas shtojcës 21, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
22. Programet mësimore të klasës së parë dhe klasës së gjashtë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2026 – 2027.
23. Programet mësimore të klasës së shtatë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2027 – 2028.
24. Programi mësimor i klasës së pestë hyn në fuqi dhe fillon zbatimin në vitin shkollor 2029 – 2030.
25. Programet mësimore të mëparshme, shfuqizohen sipas fillimit të zbatimit të programeve mësimore të lëndëve në klasat e sipërcituara.
26. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI



PROGRAMI I LËNDËS “HISTORI”

ARSIMI I MESËM I ULËT

KLASA 6

FUSHA “SHKENCAT SHOQËRORE”

PROGRAM I PËRDITËSUAR

Koordinator: Ines Todhe



PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

1	HYRJE	4
2	QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË LËNDËS	5
2.1	Objektivat e përgjithshme të lëndës së historisë në arsimin e mesëm të ulët	6
3	PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	7
4	KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA.....	12
4.1	Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit	12
4.2	Temat ndërkurrikulare dhe lidhja me lëndën e historisë.....	16
4.3	Rezultatet e të nxënit për kompetencat dhe konceptet kyçe të lëndës së historisë	18
5	PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT	27
5.1	Koha mësimore për secilën tematikë për klasën e gjashtë.....	29
5.2	Përmbajtja e klasës së gjashtë	29
5.2.1	Tematika: Qytetërimet e hershme në Antikit. (mijëvjeçarët IV – II para erës sonë)	30
5.2.2	Tematika: Qytetërimet klasike në Mesdhe. (shek. VIII para erës sonë – shek. V të erës sonë)	33
5.2.3	Tematika: Qytetërimet në mesjetën e hershme (shek. V – X)	37
5.2.4	Tematika: Zhvillimet politike dhe shoqërore në mesjetën e mesme (shek. XI – XIII).....	40
5.2.5	Tematika: Evropa në mesjetën e vonë (shek. XIV – XV).....	42

5.3	Qëndrime dhe vlera.....	46
5.3.1	Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e rezultateve të të nxënit (RN-ve)	47
6	METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES	51
6.1	Roli i situatave të të nxënit praktike nga jeta reale në mësimin e historisë	54
6.1.1	Shembull i një situatë të nxëni në klasën e VI	54
6.2	Roli i veprimtarive praktike dhe projekteve kurrikulare në lëndën e historisë	55
6.3	Puna me nxënësit me nevoja të veçanta në lëndën e historisë	57
7	VLERËSIMI I NXËNËSVE	58
7.1	Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit, RN-ve.	62
8	BURIMET DHE MATERIALET DIDAKTIKE	62
8.1	Përdorimi i teknologjisë si mjet dhe teknikë mësimore në lëndën e historisë	63
9	REKOMANDIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT.....	64
10	NDRYSHIMET E PROGRAMIT TË HISTORISË, KLASA VI	69
10.1	Përditësime në aspektet përmbajtjesore të lëndës së historisë	69
10.2	Përditësimet në aspektin metodologjik	72

1 HYRJE

Lënda e historisë zë një vend të rëndësishëm në arsimin e mesëm të ulët, pasi ndihmon nxënësit të kuptojnë më mirë botën në të cilën jetojnë përmes njohjes së zhvillimeve të shoqërisë njerëzore ndër shekuj. Studimi i ngjarjeve, proceseve, figurave dhe periudhave historike u ofron atyre mundësinë për të ndërtuar një kuptim të rrjedhshëm dhe të argumentuar për të shkuarën dhe për lidhjen e saj me të tashmen. Nëpërmjet këtij procesi, ata mësojnë se zhvillimi i institucioneve, ideve, kulturave dhe shoqërive ka ndodhur në mënyra të ndryshme në kohë dhe hapësirë, duke ndikuar plotësisht në ndërtimin e botës së sotme.

Lënda e historisë ndihmon në zhvillimin e mendimit kritik dhe të pavarur, duke i pajisur nxënësit me aftësinë për të analizuar burime, për të formuluar pyetje, për të bërë krahasime dhe për të kuptuar lidhjet shkak-pasojë midis ngjarjeve. Ata mësojnë të dallojnë midis fakteve dhe supozimeve, të vlerësojnë besueshmërinë e burimeve historike dhe të shmangin interpretimet e njëanshme, duke ndërtuar qëndrime të balancuara dhe të mbështetura në fakte. Në këtë mënyrë, ata aftësohen të nxjerrin mësim nga përvoja njerëzore dhe të formulojnë argumente të arsyetuara. Përmes hulumtimit, interpretimit dhe komunikimit të ideve, nxënësit ndër veprojnë me materiale të ndryshme: tekste, harta, ilustrime, kronologji dhe burime pamore si fotografi, piktura apo objekte historike. Kjo përvojë kontribuon në formimin e një kuptimi më të thelluar, të strukturuar dhe të ndërlidhur të përmbajtjes historike, si dhe të lidhjeve midis ngjarjeve, periudhave dhe ideve. Diskutimi, puna në grup dhe trajtimi i çështjeve nga këndvështrime të ndryshme nxisin bashkëpunimin, respektin për tjetrin dhe zhvillimin e përgjegjësisë kolektive.

Historia është e ndërlidhur me fusha e lëndë të tjera si gjeografia, edukimi qytetar, letërsia, arti dhe filozofia, duke ndihmuar nxënësit të ndërtojnë një kuptim të plotë për zhvillimin e njeriut dhe shoqërisë. Ajo shërben si mjet për zhvillimin e një identiteti të qëndrueshëm personal, kulturor dhe kombëtar. Historia luan një rol të pazëvendësueshëm në forcimin e ndjenjës së përkatësisë dhe të patriotizmit, duke i ndihmuar nxënësit të njohin rrënjët e tyre historike, trashëgiminë kulturore shqiptare dhe rolin e saj në ndërveprimin me qytetërimet e tjera botërore.

Programi i historisë në arsimin e mesëm të ulët ka në fokus studimin e historisë së qytetërimeve botërore dhe të historisë së shqiptarëve, që nga parahistoria deri në periudhat antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore. Ai trajton ngjarjet dhe proceset historike në një kornizë kronologjike

dhe tematike, duke mundësuar ndërlidhjen e brendshme dhe të jashtme ndërmjet periudhave, ngjarjeve dhe shoqërive të ndryshme, si dhe lidhjen e qytetërimit shqiptar me zhvillimet më të gjera të historisë botërore.

Vazhdimësia kronologjike respekton kriterin shkencor të rrjedhës historike dhe të lidhjes shkak-pasojë, duke ndihmuar nxënësit të kuptojnë se qytetërimet e sotme janë vazhdimësi progresive e qytetërimeve të mëparshme. Ky këndvështrim i ndihmon ata të ndërtojnë perspektiva të argumentuara për ngjarjet e së kaluarës, si dhe të parashikojnë tendencat e përgjithshme të zhvillimeve historike.

Ndërsa trajtimi tematik i përmbajtjes thekson zgjedhjen e temave thelbësore që lidhen me rrënjët dhe modelet e qytetërimeve të sotme. Ai shmang mbingarkesën me të dhëna të tepërta, duke vendosur në qendër kuptimin e fenomeneve historike, dhe duke ruajtur një ekuilibër ndërmjet kontributeve të ndryshme kulturore dhe historike në zhvillimin e qytetërimeve.

Lënda e historisë synon që nxënësit të bëhen të ditur, logjikë, të ndjeshëm, kureshtarë, dhe të aftë për të marrë vendime të balancuara. Ajo kontribuon në zhvillimin e kompetencave të nevojshme për qytetarinë demokratike dhe për përballimin e sfidave të së tashmes dhe të së ardhmes, në nivel kombëtar dhe global. Historia mësohet në të gjitha klasat e arsimit të mesëm të ulët dhe mbështet qëllimet e arsimit parauniversitar.

2 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË LËNDËS

Qëllimi i mësimi të historisë në arsimin e mesëm të ulët është të pajisë nxënësit me njohuri të qëndrueshme historike, të cilat u mundësojnë atyre të kuptojnë zhvillimin e shoqërisë njerëzore në kohë dhe hapësirë, si dhe të ndërtojnë një lidhje të vetëdijshme midis të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes. Historia shërben për të zhvilluar mendimin kritik, aftësinë për të analizuar burime dhe informacione, për të ndërtuar argumente të bazuara në fakte, si dhe për të kuptuar ndikimin e ngjarjeve dhe proceseve historike në jetën individuale dhe kolektive.

Përmes këtij programi, nxënësit inkurajohen të eksplorojnë të kaluarën në mënyrë aktive, të vlerësojnë trashëgiminë kulturore, të kuptojnë rolin e historisë në formimin e identitetit kombëtar dhe qytetar dhe të zhvillojnë një qëndrim të përgjegjshëm ndaj ngjarjeve historike dhe shoqërisë bashkëkohore. Mësimi i historisë synon gjithashtu ndërtimin e aftësive sociale, bashkëpunimin, respektin për perspektivat e ndryshme, si dhe formimin e qëndrimeve të qëndrueshme për të nxënësit gjatë gjithë jetës.

2.1 Objektivat e përgjithshme të lëndës së historisë në arsimin e mesëm të ulët

Programi i historisë lidh vlerat e të mësuarit të historisë me qëllimet e arsimit parauniversitar, me kompetencat kyçe për të nxënësit gjatë gjithë jetës dhe Rekomandimet Rek (2001)15 të Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare, për mësimdhënien e historisë në shekullin XXI, duke ndërtuar tek nxënësi konceptet, kompetencat dhe cilësitë historike. *Në përfundim të arsimit të mesëm të ulët, nxënësi pritët që:*


- Të kuptojë zhvillimin e shoqërisë njerëzore në kohë dhe hapësirë, nga parahistoria deri në epokën bashkëkohore, duke analizuar ngjarje dhe procese në kontekstin kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Të shpjegojë lidhjet shkak–pasojë ndërmjet ngjarjeve dhe fenomeneve historike dhe të reflektojë mbi ndikimin e tyre në jetën e sotme;
- Të dallojë faktet nga opinionet dhe të vlerësojë saktësinë dhe besueshmërinë e burimeve historike në kontekstin përkatës;
- Të ndërtojë argumente të bazuara në burime të ndryshme dhe t'i paraqesë ato përmes formave të ndryshme të komunikimit historik – me shkrim, gojor, vizual dhe digjital;
- Të zhvillojë aftësi për kërkim dhe analizë historike përmes përdorimit të teksteve, dokumenteve, hartave, objekteve dhe materialeve vizuale;
- Të kuptojë konceptet e kohës, vazhdimësisë dhe ndryshimit si elementë thelbësorë për të interpretuar zhvillimet historike dhe për të parashikuar ndikimin e tyre në të ardhmen;
- Të kuptojë proceset që kanë ndikuar në lindjen dhe zhvillimin e qytetërimeve në periudha të ndryshme historike, si dhe ndikimin e tyre në formimin e botës së sotme;
- Të njohë dhe të krahasojë mënyrat e ndryshme të interpretimit të së kaluarës, duke kuptuar se historia është subjekt analizash të shumanshme dhe jo një rrëfim i vetëm;
- Të zhvillojë vetëdijen për përkatësinë kulturore dhe të ndërtojë një identitet të qëndrueshëm, si në nivel personal, ashtu edhe shoqëror;
- Të vlerësojë vendin dhe rolin e qytetërimit shqiptar në kontekstin historik botëror dhe marrëdhëniet e tij me qytetërimet e tjera;
- Të kuptojë rëndësinë e trashëgimisë historike si element themelor i identitetit kombëtar dhe si mjet edukimi për brezat e rinj;

- Të forcojë ndjenjën e përkatësisë, identitetit kombëtar dhe respektit për historinë kombëtare, në përputhje me një vizion bashkëkohor dhe evropian;
- Të aftësohet për të ndërvepruar në mënyrë paqësore dhe të respektueshme me kultura të ndryshme, duke kuptuar rolin e historisë në ndërtimin e bashkëjetesës ndërkulturore;
- Të reflektojë mbi marrëdhënien ndërmjet së kaluarës dhe të tashmes, si bazë për vendimmarrje të informuar dhe të qëndrueshme në të ardhmen;
- Të zhvillojë vetëdije qytetare përmes njohjes së ideve, lëvizjeve dhe ngjarjeve që kanë ndikuar në ndërtimin e shoqërive demokratike dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- Të përdorë në mënyrë etike dhe të përgjegjshme teknologjinë gjatë procesit të kërkimit, përpunimit dhe paraqitjes së informacionit historik, duke përfshirë përdorimin e burimeve digjitale, mjeteve vizuale, platformave online dhe teknologjive të reja si mjete për të nxitur të menduarit kritik dhe komunikimin efektiv.
- Të forcojë kompetencat qytetare dhe ndjenjën e përgjegjësisë sociale, si përgatitje për jetën, punën dhe pjesëmarrjen aktive në një shoqëri demokratike.

3 PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi i historisë synon të krijojë kushte të favorshme për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave historike dhe atyre kyçe, duke u mbështetur në përmbajtje të pasur, në analiza kritike të ngjarjeve dhe burimeve, si dhe në ndërlidhjen e koncepteve historike me përvojat e jetës reale. Në thelb, ky program përqendrohet në formimin e nxënësve si individë të aftë për të kuptuar zhvillimin e shoqërisë njerëzore, për të interpretuar në mënyrë të përgjegjshme të kaluarën dhe për të ndërtuar qendra aktive në të tashmen dhe të ardhmen. Programi i lëndës së historisë në arsimin e mesëm të ulët përfshin:

- ✓ **Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënësve që zhvillohen nëpërmjet lëndës së historisë.** Lënda e historisë luan një rol të rëndësishëm në ndërtimin e kompetencave kyçe dhe në formësimin e të menduarit kritik, reflektiv dhe qytetar të nxënësve. Ajo nuk ka për detyrë vetëm transmetimin e njohurive faktike për të kaluarën, por shërben gjithashtu si një mjet edukativ i fuqishëm për zhvillimin e një sërë aftësish ndërdisiplinore dhe qëndrimesh thelbësore për jetën në një shoqëri demokratike. Në këtë kuptim, historia kontribuon drejtpërdrejt në zhvillimin e të gjitha kompetencave kyçe (*Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare; Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja; Kompetenca në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri; Kompetenca digjitale; Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënësve; Kompetenca qytetare; Kompetenca e sipërmarrjes; Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore*) të përcaktuara në Kornizën Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar. Nëpërmjet përmbajtjeve historike dhe metodave aktive të të nxënësve, nxënësit zhvillojnë aftësi për të kuptuar dhe interpretuar kontekstin shoqëror, politik dhe kulturor të ngjarjeve, si dhe për të ndërtuar argumente të strukturuar në mënyrë logjike. Historia ndihmon në ndërtimin e identitetit personal dhe kolektiv, në kuptimin e proceseve demokratike dhe në forcimin e ndërgjegjes qytetare. Përmes historisë, nxënësit përfshihen në aktivitete që nxisin ndërveprimin, reflektimin dhe komunikimin, duke ndihmuar kështu në zhvillimin e kompetencave si komunikimi në gjuhën amtare, kompetenca digjitale, qytetare dhe personale. Përfshirja e tyre në diskutime mbi drejtësinë, të drejtat e njeriut, tolerancën dhe trashëgiminë kulturore kontribuon në edukimin për jetën në një shoqëri të larmishme dhe demokratike. Në këtë formë, lënda e historisë krijon



matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri; Kompetenca digjitale; Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënësve; Kompetenca qytetare; Kompetenca e sipërmarrjes; Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore) të përcaktuara në Kornizën Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar. Nëpërmjet përmbajtjeve historike dhe metodave aktive të të nxënësve, nxënësit zhvillojnë aftësi për të kuptuar dhe interpretuar kontekstin shoqëror, politik dhe kulturor të ngjarjeve, si dhe për të ndërtuar argumente të strukturuar në mënyrë logjike. Historia ndihmon në ndërtimin e identitetit personal dhe kolektiv, në kuptimin e proceseve demokratike dhe në forcimin e ndërgjegjes qytetare. Përmes historisë, nxënësit përfshihen në aktivitete që nxisin ndërveprimin, reflektimin dhe komunikimin, duke ndihmuar kështu në zhvillimin e kompetencave si komunikimi në gjuhën amtare, kompetenca digjitale, qytetare dhe personale. Përfshirja e tyre në diskutime mbi drejtësinë, të drejtat e njeriut, tolerancën dhe trashëgiminë kulturore kontribuon në edukimin për jetën në një shoqëri të larmishme dhe demokratike. Në këtë formë, lënda e historisë krijon

një urë mes të kaluarës dhe të tashmes, duke fuqizuar nxënësit që të jenë qytetarë të informuar, të përgjegjshëm dhe të aftë për të ndikuar pozitivisht në të ardhmen e tyre dhe të komunitetit.

- ✓ ***Temat ndërkurrikulare dhe zhvillimi i tyre nëpërmjet lëndës së historisë.*** Integrimi i temave ndërkurrikulare në lëndën e historisë (identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave, qytetaria aktive dhe sipërmarrja, shëndeti mendor, fizik dhe siguria, zhvillimi i qëndrueshëm dhe mbrojtja e mjedisit, si dhe teknologjia, shoqëria dhe media), u ofron nxënësve mundësinë të ndërtojnë një kuptim të thelluar të zhvillimeve njerëzore dhe shoqërore në kohë dhe hapësirë. Në këtë mënyrë, ata mësojnë të lidhin njohuritë historike me sfidat e shoqërisë bashkëkohore, duke i bërë këto njohuri më të kuptueshme, të zbatueshme dhe të domosdoshme për jetën e përditshme. Përmes këtyre temave, nxënësit nxitën të zhvillojnë kompetenca historike thelbësore si kërkimi dhe interpretimi i burimeve, mendimi kritik, ndërtimi i argumenteve dhe komunikimi i qartë. Kjo qasje ndërthur njohuritë historike me vlera dhe qëndrime qytetare, duke i orientuar nxënësit drejt një kuptimi më të thellë dhe më të përgjegjshëm të botës, në përputhje me parimet e një shoqërie demokratike dhe të qëndrueshme.
- ✓ ***Kompetencat e lëndës dhe rezultatet e të nxënit.*** Lënda e historisë në arsimin e mesëm të ulët synon zhvillimin e kompetencave të lëndës: kërkimi historik; përdorimi i burimeve; analiza shkak-pasojë; interpretimi historik; shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën dhe të koncepteve kyçe historike: kuptimi kronologjik; ndryshimi dhe vazhdimësia; diversiteti; empatia historike; rëndësia historike. Këto elemente u mundësojnë nxënësve të ndërtojnë një dije historike të mirë strukturuar dhe të thelluar, e cila nuk kufizohet në riprodhimin e fakteve, por mbështet analizën dhe interpretimin e tyre në kontekst. Përmes përfshirjes aktive në diskutime mbi çështje të debatueshme dhe të rëndësishme për historinë dhe shoqërinë, nxënësit kuptojnë të kaluarën dhe reflektojnë mbi ndikimin që ajo ka në të tashmen. Kjo i ndihmon ata të kuptojnë më mirë rolin e qytetarit të informuar, të ndërgjegjshëm dhe aktiv në një shoqëri demokratike
- ✓ ***Përmbajtja mësimore dhe rezultatet e të nxënit.*** Programi përshkruan përmbajtjen mësimore sipas periudhave historike kryesore: parahistoria, qytetërimet e lashta, mesjeta, koha moderne dhe periudha bashkëkohore, duke ofruar njohuri të strukturuar në kontekstin botëror dhe atë shqiptar. Struktura e programit paraqet në mënyrë të qartë tematikat përkatëse për çdo klasë, veprimtaritë praktike, shpërndarjen e orëve mësimore dhe rezultatet e pritshme të të nxënit për secilën tematikë. Në qendër të programit qëndrojnë zhvillimi i aftësive të kërkimit, analizës, interpretimit dhe argumentimit, si dhe aftësia për të lidhur ngjarjet historike me realitetin bashkëkohor. Kjo qasje ndihmon nxënësit jo vetëm

të kuptojnë rrjedhën e historisë dhe ndikimin e saj në shoqërinë e sotme, por edhe të formojnë qëndrime të ndërgjegjshme dhe kritike ndaj sfidave aktuale dhe zhvillimeve të ardhshme.

- ✓ **Metodologjia e mësimdhënies.** Në lëndën e historisë është e domosdoshme përdorimi i metodave aktive dhe bashkëkohore të të nxënit, të cilat e vendosin nxënësin në qendër të procesit mësimor dhe e inkurajojnë atë të angazhohet në mënyrë të drejtpërdrejtë me përmbajtjen historike. Ndër këto metoda përfshihen të mësuarit përmes burimeve historike, studimi i rasteve konkrete, puna në grup, debati i strukturuar, veprimtaritë praktike, dramatizimi i ngjarjeve, ndërtimi i linjës së kohës etj. Përdorimi i këtyre metodave synon jo vetëm përvetësimin e dijes faktike, por edhe zhvillimin e aftësive analitike, mendimit kritik, zgjidhjes së problemit, përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), empatisë historike dhe vetëdijes qytetare. Për më tepër, programi parashikon përshtatje të metodologjisë për nxënësit me nevoja të veçanta, duke ofruar forma të diferencuara të mësimdhënies dhe të vlerësimit, në mënyrë që të sigurohet përfshirje dhe barazi në procesin e të nxënit për të gjithë. Njëkohësisht, ai krijon hapësira për të identifikuar dhe mbështetur nxënësit me prirje dhe talent të veçantë në fushën e historisë, përmes detyrave sfiduese dhe veprimtarive kërkimore e krijuese, që nxisin thellimin e dijes dhe zhvillimin e potencialit individual në mënyrë të qëndrueshme dhe afatgjatë.
- ✓ **Vlerësimi i nxënësve.** Ndër format më të përdorura të vlerësimit përfshihen detyrat krijuese, veprimtaritë praktike, konkurset, esetë, projektet kërkimore individuale apo në grup, si dhe vetëvlerësimi nga ana e nxënësve, me qëllim nxitjen e reflektimit dhe ndërgjegjësimin mbi procesin e të nxënit. Këto forma vlerësimi nuk synojnë vetëm matjen e njohurive faktike, por edhe zhvillimin e aftësive analitike, të mendimit kritik, të shprehjes së ideve dhe të punës bashkëpunuese. Ato u japin nxënësve mundësinë të demonstrojnë kompetencat në mënyra të ndryshme, duke respektuar stilin e tyre individual të të nxënit dhe duke i inkurajuar të marrin një rol aktiv dhe të vetëdijshëm në procesin e vlerësimit. Kjo qasje krijon hapësira për të shprehur mendimin, për të reflektuar mbi përparimin personal dhe për të përmirësuar vazhdimisht rezultatet në përputhje me objektivat e të nxënit, duke i orientuar nxënësit drejt një procesi më të ndërgjegjshëm dhe të pavarur të zhvillimit arsimor.
- ✓ **Burimet dhe materialet didaktike.** Përdorimi i burimeve të shumëllojshme si: tekste, harta historike, fotografi, objekte muzeale, dokumente arkivore, platforma digjitale dhe dokumentarë, është thelbësor për të nxitur interesin dhe angazhimin e nxënësve në procesin e të nxënit. Këto burime ndihmojnë në konkretizimin e ngjarjeve dhe proceseve historike, duke i bërë ato më të kuptueshme dhe më afër përvojës së nxënësit.

Ato shërbejnë gjithashtu si bazë për zhvillimin e aftësive të kërkimit, analizës, interpretimit dhe mendimit kritik. Teknologjia, në këtë kontekst, përdoret si mjet mbështetës për kërkimin e informacionit, vizualizimin e periudhave historike dhe prezantimin e njohurive të fituara. Ajo u ofron nxënësve mundësi për të eksploruar përmes mjeteve interaktive, duke nxitur pjesëmarrjen aktive dhe ndërtimin e një kuptimi më të pasur dhe reflektues për të kaluarën.

- ✓ **Rekomandime për zbatimin e programit.** Në këtë rubrikë jepen udhëzime të posaçme për mësuesit, hartuesit e teksteve dhe vlerësuesit, me synimin për të siguruar që përmbajtja mësimore të përshtatet në mënyrë të plotë me nevojat, interesat dhe nivelin e zhvillimit të nxënësve. Rekomandimet theksojnë domosdoshmërinë për të zbatuar një qasje të ndjeshme dhe të balancuar ndaj përmbajtjes historike, duke marrë parasysh larminë kulturore dhe kontekstin shoqëror në të cilin zhvillohet mësimi. Në veçanti, theksohet rëndësia e lidhjes mes historisë dhe lëndëve të tjera si gjuha, qytetaria, arti apo teknologjia, për të forcuar kuptimin e ndërlidhur të dijes. Po ashtu, nënvizohet nevoja për fleksibilitet në zgjedhjen e metodave mësimore, duke u dhënë mësuesve hapësirë për të përshtatur strategjitë e tyre sipas dinamikës së klasës. Inkurajohet përdorimi i metodave që promovojnë mendimin kritik, ndjeshmërinë qytetare, empatinë historike dhe ndërgjegjësimin për identitetin kulturor dhe kombëtar, me qëllim formimin e nxënësve si qytetarë të ndërgjegjshëm, aktivë dhe të përgjegjshëm.
- ✓ **Ndryshimet e programit.** Kjo rubrikë përshkruan përditësimet kryesore të ndërmarra në programin e historisë, me qëllim përmbushjen e synimeve kombëtare të arsimit parauniversitar dhe forcimin e qasjes bazuar në kompetenca. Ndryshimet kanë për qëllim të ofrojnë një përmbajtje dhe metodologji më të përshtatshme dhe të balancuar për zhvillimin e mendimit kritik dhe kompetencave historike tek nxënësit, në përputhje me kërkesat e një shoqërie demokratike të ndërlidhur globalisht. Përditësimet përqendrohen në rëndësinë që historia duhet t'i kushtojë trajtimit të zhvillimeve të reja shoqërore, ndryshimeve klimatike dhe mjedisore, zhvillimit të qëndrueshëm dhe nevojës për bashkëjetesë paqësore në një botë gjithnjë e më komplekse. Programi i përditësuar përfshin tema ose veprimtari që trajtojnë ndjenjën e patriotizmit, identitetin kombëtar, pakicat kombëtare, trashëgiminë kulturore dhe ndikimet ndërkulturore. Njëkohësisht, ai nxit ndërgjegjësimin për diversitetin, bashkëjetesën dhe dialogun ndërkulturor, si elemente themelore të edukimit për jetesën në një shoqëri të hapur, gjithëpërfshirëse dhe demokratike. Vëmendje i kushtohet edhe trajtimit të çështjeve që lidhen me rreziqet natyrore, pandemitë, si dhe krizat ekonomike dhe politike, duke theksuar mënyrën se si historia ndihmon në kuptimin dhe përballimin e sfidave bashkëkohore. Një vend të veçantë në program

zë gjithashtu trajtimi i rolit të zhvillimeve teknologjike në transformimin e jetës shoqërore dhe të realitetit bashkëkohor, si në të tashmen ashtu edhe në perspektivën e ardhshme. Këto përditësime e bëjnë programin më gjithëpërfshirës dhe më të përditësuar, duke e harmonizuar me rekomandimet e Këshillit të Evropës për mësimdhënien e historisë në shekullin XXI. Në këtë mënyrë, programi synon të përgatisë nxënësit për një qytetari aktive, kritike dhe të ndërgjegjshme në një botë dinamike dhe në ndryshim të vazhdueshëm.

4 KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA

4.1 Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit

Zhvillimi i kompetencave kyçe përmes mëimit të historisë kërkon që mësuesi të sigurojë lidhje të qëndrueshme ndërmjet kompetencave kyçe dhe atyre historike, sipas klasave të arsimit të mesëm të ulët. Kjo kërkon një planifikim të kujdesshëm të situatave të të nxënit, si dhe përzgjedhjen e metodave, mjeteve dhe burimeve të përshtatshme që nxisin angazhimin, reflektimin dhe zbatimin praktik të njohurive. Kompetenca është një ndërthurje e balancuar mes njohurive, aftësive, qëndrimeve, vlerave dhe mendimit kritik, që mundësojnë nxënësin të përballet me situata reale dhe komplekse në mënyrë efektive dhe të pavarur. Qasja e mësimdhënies e bazuar në kompetenca e zhvendos fokusin nga përvetësimi pasiv i përmbajtjes lëndore (me mësuesin si qendër të procesit) drejt formimit të aftësive që ndihmojnë nxënësin të kuptojë, të zbatojë dhe të transferojë njohuritë në situata të reja dhe jetësore, duke u vendosur vetë nxënësi në qendër të procesit. Rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe që mund të zhvillojë nxënësi në arsimin e mesëm të ulët në lëndën e historisë mund të përmbledhen si më poshtë:

Tabela 1. Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit

Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare	Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja
<i>Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhën amtare, nxënësi:</i> - përdor gjuhë të saktë dhe të pasur për të treguar, përshkruar dhe analizuar ngjarje dhe figura historike;	<i>Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhë të huaj, nxënësi:</i>

- ndërton dhe paraqet argumente historike në formë gojore dhe të shkruar; - merr pjesë në diskutime historike duke dëgjuar dhe respektuar mendimet e të tjerëve; - përpunon informacionin nga burime të ndryshme historike dhe e organizon atë në mënyrë të qartë dhe logjike; - përdor fjalorin historik për të shprehur mendimet dhe për të kuptuar përmbajtjen mësimore.	- njeh dhe përdor terma të thjeshtë historikë në gjuhë të huaj në kontekst të temave ndërkombëtare; - përfshihet në diskutime të thjeshta mbi ngjarje historike me rëndësi botërore; - përdor materiale të thjeshta në gjuhë të huaj (tekste, video) për të zgjeruar njohuritë historike; - prezanton projekte ose fakte historike përmes mjeteve digjitale dhe komunikimit elektronik në gjuhë të huaj.
Kompetenca në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri	Kompetenca digjitale
<i>Për të dëshmuar kompetencat në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri, nxënësi:</i> - kupton ndikimin e zhvillimeve shkencore dhe teknologjike në ecurinë e historisë; - lidh zbulimet shkencore, shpikjet dhe zhvillimet teknologjike me periudha të caktuara historike; - analizon ndryshimet në mënyrën e jetesës dhe punës përmes kohëve, si pasojë e përparimeve teknologjike; - përdor harta, grafikë dhe skema për të paraqitur zhvillime historike me logjikë të qartë.	<i>Për të dëshmuar kompetencën digjitale, nxënësi:</i> - përdor burime digjitale (faqe zyrtare, arkiva online, platforma mësimore) për të kërkuar dhe analizuar informacion historik; - krijon prezantime, afishe dhe materiale të tjera vizuale për të komunikuar përmbajtje historike; - menaxhon burimet e informacionit në mënyrë të sigurt dhe etike; - përdor teknologjinë për të paraqitur zhvillime kronologjike dhe për të analizuar dokumente historike. - përdor inteligjencën artificiale për të analizuar dhe interpretuar të dhëna dhe për të zgjidhur problem; - bashkëpunon me moshatarët duke përdorur teknologjinë për zgjidhjen e problemeve si dhe për të zhvilluar projekte.

Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënit	Kompetenca qytetare
<i>Për të dëshmuar kompetencën personale, shoqërore dhe të nxënies, nxënësi:</i> - reflekton mbi të mësuarit personal dhe përmirëson mënyrat e të nxënit; - punon në mënyrë të pavarur dhe në grup për të zhvilluar projekte historike; - negocion dhe zgjidh konflikte në mënyrë konstruktive, menaxhon stresin; - vlerëson jetesën e shëndetshme dhe praktikon zakone të shëndetshme ushqimore dhe fizike; - shpreh dëshirë për të nxënit gjatë gjithë jetës dhe bashkëpunon në mënyrë konstruktive; - demonstroi ndjeshmëri dhe respekt ndaj përvojave të tjera historike dhe kulturave të ndryshme; - përvetëson qëndrime të përgjegjshme dhe të vetëdijshme në raport me historinë dhe trashëgiminë - identifikon dhe përmirëson përparësitë dhe dobësitë personale; - organizon dhe fokusohet në të nxënit, vendos qëllime dhe vlerëson punën e tij;	<i>Për të dëshmuar kompetencën qytetare, nxënësi:</i> - identifikon të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në shoqëri përmes përvojave historike; - demonstroi respekt për historinë kombëtare dhe trashëgiminë kulturore; - vlerëson diversitetin me tolerancë dhe respekt; - demonstroi vlerat e të drejtave të njeriut, si respekti për dinjitetin personal dhe lufta kundër diskriminimit; - analizon rolin e individëve dhe grupeve në ndryshime historike me ndikim shoqëror; - merr pjesë në diskutime për temat historike që lidhen me të drejtat e njeriut, barazinë dhe paqen; - tregon solidaritet në zgjidhjen e problemeve në shkollë, komunitet e më gjerë; - menaxhon dhe zgjidh konfliktet në mënyrë konstruktive dhe të paanshme; - demonstroi sjellje etike ndaj mjedisit dhe kontribuon në qëndrueshmërinë mjedisore;

- motivon dhe vlerëson veten, punon në mënyrë të pavarur dhe në grup; - analizon dhe zgjidh probleme emocionale dhe sociale, duke propozuar alternativa pozitive.	- reagon ndaj shkeljeve të të drejtave të të tjerëve dhe diskuton pasojat e këtyre veprimeve.
Kompetenca e sipërmarrjes	Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore
<i>Për të dëshmuar kompetencën e sipërmarrjes, nxënësi:</i> - planifikon dhe zhvillon projekte historike që lidhen me ngjarje, figura ose trashëgimi kulturore; - demonstroi kreativitet dhe zgjidhje inovative në trajtimin e temave historike; - përfshihet në organizimin e aktiviteteve si ekspozita, dramatizime apo fushata mbi ngjarje historike; - përdor burime dhe mjete për të realizuar në mënyrë të strukturuar nisma me përmbajtje historike - punon në mënyrë të pavarur dhe në grup për zhvillimin e komunitetit; - analizon pasojat e dëmtimit të mjedisit dhe organizon aktivitete për mbrojtjen e tij; - përdor materiale dhe teknologjinë për avancim në mësim dhe orientim në karrierë.	<i>Për të dëshmuar kompetencën për vetëdijen dhe shprehjen kulturore, nxënësi:</i> - njeh dhe vlerëson vlerat e trashëgimisë kulturore shqiptare dhe botërore; - shpreh mendime dhe emocione në lidhje me figura, ngjarje apo simbole historike përmes mjeteve artistike; - merr pjesë në veprimtari që promovojnë ruajtjen dhe pasurimin e trashëgimisë historike; - interpreton ngjarje historike përmes ekspozitave, dramave, ngjarjeve gojore apo krijimeve vizuale.

4.2 Temat ndërkurrikulare dhe lidhja me lëndën e historisë

Integrimi i temave ndërkurrikulare në lëndën e historisë u mundëson nxënësve të ndërtojnë një kuptim të thelluar të zhvillimeve njerëzore dhe shoqërore në kohë dhe hapësirë, duke i ndihmuar ata të lidhin njohuritë historike me sfidat bashkëkohore. Këto tema nxisin zhvillimin e kompetencave historike si kërkimi, interpretimi, mendimi kritik, argumentimi dhe komunikimi, në përputhje me një qasje qytetare, demokratike dhe të qëndrueshme ndaj botës. Lënda e historisë trajton temat ndërkurrikulare në mënyrë natyrore, nëpërmjet përmbajtjes dhe kompetencave që zhvillon. Ajo synon formimin e qytetarit të së ardhmes: një individ të aftë për të reflektuar, për të bashkëjetuar në një botë të ndërruar dhe për të kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Gjatë zhvillimit të këtyre temave, nxënësi angazhohet në zgjidhjen e situatave konkrete, përdor aftësitë e mendimit kritik dhe krijues, si dhe aplikon kompetencat historike si: kërkimi, përdorimi i burimeve, interpretimi dhe komunikimi, për të shpjeguar, argumentuar dhe parashikuar perspektiva mbi çështje me rëndësi të gjerë.

- ✓ *Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.* Lënda e historisë luan një rol thelbësor në ndërtimin e identitetit kombëtar dhe ndërkulturor të nxënësit. Përmes njohjes së figurave historike, ngjarjeve formuese dhe trashëgimisë kulturore materiale e shpirtërore, nxënësi ndërton vetëdijen për përkatësinë e tij dhe vendin që zë në komunitetin kombëtar dhe më gjerë. Analiza e dokumenteve historike, simboleve, artefakteve dhe rrëfimeve të kulturave të ndryshme ndihmon në formimin e identitetit personal dhe kolektiv. Historia ndihmon gjithashtu në zhvillimin e respektit dhe mirëkuptimit për pakicat kombëtare dhe kulturat e tjera. Duke studiuar marrëdhëniet ndërmjet qytetërimeve, shkëmbimet kulturore, ndikimet reciproke dhe përvojat e përbashkëta njerëzore, nxënësi zhvillon ndjeshmëri ndërkulturore dhe aftësi për të bashkëjetuar në një shoqëri të larmishme, të hapur, tolerante dhe demokratike.
- ✓ *Qytetaria aktive dhe sipërmarrja.* Historia i ofron nxënësit një kuadër të pasur për të kuptuar konceptin e qytetarisë aktive dhe për të zhvilluar ndjenjën e përgjegjësisë shoqërore. Përmes studimit të institucioneve historike, modeleve të qeverisjes, lëvizjeve për të drejtat e njeriut dhe transformimeve shoqërore, nxënësi mëson se si qytetarët e angazhuar kanë ndikuar në zhvillimin e shoqërive më të drejta dhe më përfshirëse. Duke analizuar shembuj konkretë nga historia ku individët apo grupet kanë ndërmarrë iniciativa për ndryshim, nxënësi kupton rëndësinë e

pjesëmarrjes aktive, bashkëpunimit dhe solidaritetit në jetën publike. Kjo ndihmon në formimin e qëndrimeve pro aktive dhe sipërmarrëse, jo vetëm në fushën ekonomike, por edhe në kontekste kulturore, sociale dhe qytetare, si kontribute për ndërtimin e një komuniteti më të përgjegjshëm dhe gjithëpërfshirës.

- ✓ *Shëndeti mendor, fizik dhe siguria.* Lënda e historisë ndihmon nxënësin të kuptojë se konceptet e shëndetit, higjienës, mbrojtjes fizike dhe mirëqenies mendore kanë evoluar në periudha të ndryshme historike dhe kanë ndikuar në zhvillimin e shoqërive. Nëpërmjet studimit të kushteve të jetesës, trajtimit të sëmundjeve, përkujdesjes shëndetësore dhe zakoneve të jetesës në kohë të ndryshme, nxënësi reflekton mbi rëndësinë e shëndetit si të drejtë universale dhe si faktor i stabilitetit shoqëror. Ai mëson të vlerësojë ndikimin e krizave shëndetësore në rrjedhën e historisë (si pandemia e murtajes, gripi spanjoll, COVID-19), si dhe të ndërgjegjësohet për rolin e kujdesit ndaj vetes dhe komunitetit në historinë njerëzore
- ✓ *Zhvillimi i qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria mjedisore.* Përmes historisë, nxënësi kupton se marrëdhënia ndërmjet njeriut dhe mjedisit ka qenë një faktor përcaktues për zhvillimin ose rënien e shumë qytetërimeve. Ai mëson të analizojë se si mënyrat e jetesës, prodhimit dhe konsumit kanë ndikuar në shfrytëzimin ose ruajtjen e burimeve natyrore dhe të ambientit. Shembuj historikë si shpyllëzimi masiv, ndotja industriale, rrënimi i tokave bujqësore, apo përhapja e sëmundjeve për shkak të kushteve mjedisore të këqija, i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë pasojat afatgjata të veprimeve njerëzore. Në mënyrë të veçantë, historia shërben si mjet për të kuptuar origjinat dhe përshkallëzimin e krizës së ngrohjes globale, nëpërmjet analizës së Revolucionit Industrial, zhvillimit të transportit dhe industrive ndotëse, si dhe rritjes së konsumit në shekujt XX–XXI. Nxënësi ndërton vetëdijen se ngrohja globale nuk është një fenomen i shkëputur nga rrjedha historike, por një pasojë e drejtpërdrejtë e zgjedhjeve të bëra ndër shekuj. Përmes kësaj teme, nxënësi inkurajohet të reflektojë mbi domosdoshmërinë e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe përgjegjësie ndër breznor, duke vlerësuar shembuj pozitivë e negativë nga historia dhe duke menduar në mënyrë kritike për rolin që mund të luajë sot në ruajtjen e mjedisit dhe në ndërtimin e një të ardhmeje më të qëndrueshme për të gjithë.
- ✓ *Teknologjia, shoqëria dhe media.* Historia ofron një këndvështrim të thellë mbi mënyrën se si teknologjia dhe mjetet e komunikimit kanë ndikuar në ndryshimet shoqërore gjatë kohëve. Nga shpikja e shtypshkronjës, te ndikimi i radios, televizionit dhe më vonë i internetit dhe rrjeteve sociale, nxënësi mëson të analizojë sesi është shpërndarë informacioni, si janë ndërtuar narrativet publike dhe si është përdorur media

për të ndikuar në mendimin shoqëror. Kjo e ndihmon të zhvillojë mendim kritik për burimet historike dhe aktuale, si dhe të kuptojë rëndësinë e informacionit të besueshëm në formimin e një shoqërie të informuar.

Veprimtaritë praktike të zhvillimit të temave ndërkurrikulare mund të përshkruhen në udhëzuesit kurrikularë lëndorë.

4.3 Rezultatet e të nxënit për kompetencat dhe konceptet kyçe të lëndës së historisë

Lënda e historisë në arsimin e mesëm të ulët synon zhvillimin e kompetencave të lëndës: kërkimi historik; përdorimi i burimeve; analiza shkaku; interpretimi historik; shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën dhe të koncepteve kyçe historike: kuptimi kronologjik; *ndryshimi dhe vazhdimësia; diversiteti; empatia historike*; rëndësia historike. Këto kompetenca zërthehen në rezultate të nxëni për secilën klasë si më poshtë.

Tabela 2: Kompetencat historike dhe rezultatet e të nxënit

Kompetencat historike që zhvillohen përmes tematikave	Përshkrimi i kompetencave	Rezultatet e të nxënit për kompetencat për klasën e gjashtë
<i>Kërkimi historik</i>	Kërkimi historik përfshin identifikimin e ngjarjeve historike, formulimin e pyetjeve dhe hipotezave, si dhe kërkimin e burimeve për të ndërtuar argumente të bazuara në prova. Nxënësi mëson të strukturojë kërkesa dhe pyetje historike për të orientuar kërkimin, të mbledhë dhe analizojë të dhëna nga burime të ndryshme dhe të vlerësojë vlerën dhe kufizimet e këtyre burimeve. Gjatë procesit të kërkimit, ai zhvillon aftësi për të testuar hipotezat, për të ndërtuar përfundime logjike dhe	Nxënësi: ➤ Formulon pyetje të thjeshta për të kuptuar aspektet kryesore të jetës në qytetërimet e lashta dhe mesjetare (si organizimi, besimet, zhvillimet kulturore ose marrëdhëniet shoqërore). ➤ Përdor materiale të ndryshme (tekste, imazhe, harta, dokumente të thjeshtuara) për të mbledhur informacione rreth mënyrës së jetesës dhe veçorive të qytetërimeve të studiuara. ➤ Shpjegon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme rezultatet e kërkimit të vet, duke përdorur fjalor të përshtatshëm historik.

	për të mbështetur interpretimet e veta mbi ngjarjet dhe proceset historike.	
<i>Përdorimi i burimeve</i>	Njohja e së kaluarës mbështetet në prova të nxjerra nga burime të sakta historike, të cilat shërbejnë si dëshmi për të kuptuar ngjarjet, mënyrat e jetesës, besimet dhe përvojat e njerëzve në kohë të ndryshme. Këto burime mund të jenë të shkruara, pamore, materiale ose gojore, dhe secili lloj burimi ofron informacione të veçanta që ndihmojnë në ndërtimin e një pamjeje më të plotë të së shkuarës. Përdorimi i burimeve historike kërkon vlerësim të kujdesshëm të origjinës së tyre (nga kush janë krijuar), qëllimit për të cilin janë prodhuar, si dhe të gjuhës që përdorin nëse është neutrale apo e ngarkuar me qëndrime. Nxënësit mësojnë se jo të gjitha burimet janë të barasvlershme për nga besueshmëria, dhe se për të kuptuar më saktë të kaluarën, duhet të krahasohen burime të ndryshme, të shihet se çfarë thonë dhe çfarë mund të kenë lënë jashtë.	Nxënësi ➤ Shpjegon çfarë janë burimet historike dhe përse janë të rëndësishme për të mësuar rreth së kaluarës. ➤ Dallon disa lloje burimesh që përdoren për të mësuar rreth qytetërimeve të lashta dhe mesjetare, si: të shkruara (tekste, dokumente), pamore (harta, ilustrime, piktura, objekte), materiale (monedha, vegla, ndërtesa) dhe gojore (tregime të transmetuara brez pas brezi). ➤ Zgjedh dhe përdor burime të thjeshta historike për të mbledhur informacion mbi mënyrën e jetesës, organizimin dhe kulturën e qytetërimeve antike dhe mesjetare. ➤ Krahason informacionet që vijnë nga burime të ndryshme për të krijuar një pamje më të plotë mbi temën dhe kupton se burimet e ndryshme mund të japin këndvështrime të ndryshme për të njëjtën ngjarje. ➤ Fillon të kuptojë që jo të gjitha burimet janë të njëjta – disa janë më të besueshme se të tjerat dhe përpiqet të vlerësojë se cilat informacione janë më të sigurt për t'u përdorur.
<i>Analiza shkak–pasojë</i>	Analiza shkak–pasojë është një nga kompetencat thelbësore të të kuptuarit historik. Ajo nënkupton aftësinë e nxënësit për të identifikuar faktorët që ndikojnë në zhvillimin e një	Nxënësi: ➤ Dallon dhe përshkruan disa shkaqe që kanë çuar në krijimin, lulëzimin ose rënien e qytetërimeve antike dhe mesjetare (si për

	ngjarjeje ose procesi historik dhe për të kuptuar pasojat që rrjedhin nga to. Kjo analizë nuk qëndron vetëm në renditjen kronologjike të fakteve, por kërkon ndërlidhje logjike ndërmjet arsyeve që çojnë në një ngjarje dhe ndryshimeve që ajo shkakton në shoqëri, në mënyrën e jetesës apo në marrëdhëniet ndërmjet popujve. Në këtë proces, nxënësi mëson të kuptojë se një ngjarje historike mund të ketë më shumë se një shkak dhe të prodhojë pasoja afatshkurtra dhe afatgjata. Ai fillon të ndërtojë lidhje ndërmjet të kaluarës dhe të tashmes dhe të zhvillojë aftësinë për të argumentuar se si dhe pse ndodhin ndryshimet në histori. Përmes kësaj kompetence, nxënësi zhvillon gjithashtu të menduarin kritik, duke vlerësuar rëndësinë relative të faktorëve dhe duke bërë dallimin midis shkakut të drejtpërdrejtë, shkakut të thellë, dhe rastësisë historike.	shembull: pozita gjeografike, organizimi politik, luftërat, besimet fetare). ➤ Kupton dhe shpjegon pasoja të caktuara të ngjarjeve historike (si ndarja e perandorive, përhapja e ideve ose ndryshimi i mënyrës së jetesës). ➤ Lidh ngjarje të ndryshme historike përmes marrëdhënieve shkak-pasojë, duke përdorur shembuj konkretë nga qytetërimet e studiuara. ➤ Përdor fjalë kyçe si “sepse”, “për shkak të”, “si rezultat i” për të ndërtuar shpjegime logjike të ngjarjeve historike. ➤ Kupton se një ngjarje mund të ketë më shumë se një shkak dhe se pasojat mund të shtrihen në kohë të ndryshme. ➤ Shpjegon se si ndodhitë e së kaluarës kanë ndikuar në zhvillimet që ndihen edhe sot.
Interpretimi historik	Interpretimi historik është aftësia për të kuptuar se historia nuk tregohet gjithmonë në të njëjtën mënyrë, por ndërtohet mbi bazën e burimeve të ndryshme dhe këndvështrimeve që ndryshojnë në varësi të kohës, vendit dhe autorit që e rrëfen. Nxënësi mëson se ngjarjet, figurat apo periudhat historike mund të interpretohen ndryshe, në varësi të rrethanave kulturore, politike dhe sociale të kohës kur janë shkruar apo	Nxënësi: ➤ Kupton që e kaluara mund të paraqitet ndryshe në varësi të burimeve që përdoren dhe qëllimit të atyre që e përshkruajnë atë. ➤ Vëren dallime ndërmjet mënyrës se si përshkruhen qytetërimet antike apo mesjetare në libra, filma, tekste mësimore, muze apo rrëfime të ndryshme.

	paraqitur këto interpretime. Interpretimi nuk varet vetëm nga faktet, por edhe nga mënyra se si ato zgjidhen, përzgjidhen dhe prezantohen. Nxënësi kupton se historianët, arkeologët, artistët, shkrimtarët dhe edukatorët përdorin burime të ndryshme për të krijuar rrëfime të ndryshme mbi të njëjtën periudhë historike. Në këtë mënyrë, ai fillon të zhvillojë një qëndrim kritik ndaj asaj që lexon apo sheh, duke pyetur: Kush e ka thënë? Pse e ka thënë? Çfarë tjetër mund të thuhej ndryshe? Interpretimi historik ndihmon nxënësin të kuptojë ndikimin e mediave, të artit dhe të edukimit në formimin e mendimit për të kaluarën, dhe forcon vetëdijen se historia është gjithmonë një proces në ndërtim e sipër.	➤ Pyet dhe analizon pse një figurë historike apo një ngjarje është paraqitur në mënyrë pozitive në një burim dhe më neutrale apo kritike në një tjetër. ➤ Diskuton mbi faktin se interpretimet historike mund të ndryshojnë me kalimin e kohës dhe në vende të ndryshme. ➤ Fillon të ndërtojë vetë një mendim të argumentuar mbi qytetërimet e studiara, duke përdorur burime të thjeshta (tekste, ilustrime, video, tregime) dhe duke vlerësuar në mënyrë të vetëdijshme se çfarë ndikimesh kanë burimet mbi mënyrën si kuptojmë të kaluarën. ➤ Interpreton me fjalë të thjeshta, duke e mbështetur në burime dhe duke pranuar që nuk ka vetëm një të vërtetë për çdo ngjarje historike.
<i>Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën</i>	Kjo kompetencë përfshin aftësinë e nxënësit për të kuptuar dhe shpjeguar të kaluarën historike në mënyrë të saktë, të organizuar dhe të kuptueshme, duke përdorur gjuhë të përshtatshme dhe mjete komunikimi të ndryshme. Nxënësi mëson të rendisë ngjarjet historike sipas kronologjisë, të përzgjedhë informacione të rëndësishme dhe t'i paraqesë ato në mënyrë të qartë përmes të folurit, të shkruarit apo mjeteve vizuale. Një pjesë e rëndësishme e kësaj kompetence është edhe përdorimi i teknologjisë dhe i inteligjencës artificiale (IA) si	Nxënësi: ➤ Përshkruan ngjarje dhe figura historike duke përdorur fjalor të thjeshtë dhe kronologji të saktë; ➤ Organizon dhe paraqet informacionin në mënyrë të strukturuar, përmes shkrimit, të folurit apo skemave vizuale (harta mendore, diagrame, kronologji); ➤ Përdor teknologjinë dhe mjete digjitale (kompjuter, platforma online, aplikacione edukative) për të kërkuar dhe përpunuar informacion mbi qytetërimet e lashta dhe mesjetare;

	mjet për kërkimin, organizimin, interpretimin dhe komunikimin e informacionit historik. Nxënësi nxit të menduarin kritik në vlerësimin e përmbajtjes që gjenerohet nga mjete digjitale, mëson të kuptojë dallimin mes informacionit të saktë dhe atij të pabazuar, si dhe zhvillon sjellje etike në përdorimin e teknologjisë dhe IA-së, duke respektuar privatësinë dhe autorësinë.	➤ Aplikon mjete të thjeshta të inteligjencës artificiale (p.sh. mjete kërkimi me IA, sugjerime për përmbledhje, asistentë digjitalë edukativë) për të mbledhur ose strukturuar të dhënat historike. ➤ Reflekton mbi saktësinë dhe burimin e informacionit të marrë nga IA, duke shfaqur mendim kritik dhe përgjegjësi në përdorimin e tij. ➤ Tregon sjellje etike gjatë përdorimit të teknologjisë dhe IA-së, duke respektuar të dhënat, autorësinë dhe qëllimin edukativ të përmbajtjes. ➤ Ndërton dhe paraqet një material të shkurtër (p.sh. poster digjital, prezantim, kolazh online) mbi një qytetërim antik ose mesjetar duke kombinuar informacion të përftuar nga burime të ndryshme, përfshirë teknologjinë dhe IA-në.
--	---	---

Tabela 3: Konceptet kyçe historike dhe rezultatet e të nxënit

Kompetencat historike që zhvillohen përmes tematikave	Përshkrimi i kompetencave	Rezultatet e të nxënit për kompetencat për klasën e gjashtë
Kronologjia	Kronologjia është një koncept bazë në mësimin e historisë dhe nënkupton aftësinë për të kuptuar rendin kohor të ngjarjeve dhe për t'i vendosur ato në periudhën përkatëse historike. Nëpërmjet këtij koncepti, nxënësi mëson të përdorë me saktësi datat, shekujt, emërtimet e periudhave, si	Nxënësi: ➤ Përdor saktë datat dhe fjalorin për periudha të ndryshme historike, duke përfshirë periudhën parahistorike, antike, mesjetare. ➤ Përdor datat dhe termat themelore kronologjike si “para Krishtit (p.K.)”, “pas Krishtit (p.K.)”, “shekulli”, “epokë”, “mesjetë”;

	dhe fjalorin kronologjik që ndihmon në renditjen dhe krahasimin e ngjarjeve të së kaluarës. Kuptimi kronologjik ndihmon në ndërtimin e një strukture të qartë për të kuptuar të kaluarën dhe për të ndjekur vijimësinë, ndryshimin dhe vazhdimësinë historike. Ai është themeli mbi të cilin ngrihen aftësi të tjera historike, si analiza shkak-pasojë, interpretimi dhe krahasimi i periudhave.	➤ Rendit me saktësi ngjarje dhe figura historike në një linjë kohore të thjeshtë, duke respektuar vijimësinë kronologjike. ➤ Kupton dallimet ndërmjet periudhave historike (parahistoria, antikiteti, mesjeta) dhe identifikon tiparet e tyre kryesore. ➤ Lidh ngjarjet historike të qytetërimeve antike dhe mesjetare me kohën përkatëse duke përdorur referenca të sakta kronologjike. ➤ Kryen llogaritje të thjeshta kohore, si përcaktimi i shekullit nga një vit ose krahasimi i dy datave historike. ➤ Ndërton tabela ose skema të thjeshta për të krahasuar ngjarje historike të ndodhura në periudha të ndryshme.
Ndryshimi dhe vazhdimësia	Kuptimi i ndryshimit dhe i vazhdimësisë përbën një nga komponentët kryesorë të të menduarit historik. Ky koncept ndihmon nxënësin të kuptojë se historia nuk është një proces i pandërprerë ndryshimi të menjëhershëm, por një rrjedhë e ngjarjeve dhe përvojave ku disa aspekte të jetës politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore ndryshojnë, ndërsa të tjera mbeten të qëndrueshme në kohë. Nëpërmjet këtij koncepti, nxënësi mëson të identifikojë ndryshimet që ndodhin brenda një periudhe të caktuar, si p.sh. nga fillimi në fund të mesjetës, të krahasojë periudha të ndryshme historike, si antikiteti me mesjetën, dhe të dallojë vazhdimësinë e zakoneve, institucioneve apo ideve që përcillen nga një epokë në tjetrën. Ai fillon të kuptojë se jo	Nxënësi ➤ Dallon elementë që kanë ndryshuar dhe që kanë mbetur të qëndrueshëm në jetën e qytetërimeve të lashta dhe mesjetare (si mënyra e qeverisjes, besimet, teknologjia, ndërtimet, organizimi i jetës së përditshme). ➤ Krahason qytetërimet e periudhës antike me ato mesjetare, duke theksuar ndryshime dhe vazhdimësi në mënyrën e jetesës, në besime apo në organizimin shoqëror. ➤ Shpjegon se disa ide, si ndërtimi i qytet-shteteve, besimi në hyjni apo organizimi i pushtetit, kanë mbetur të pranishme edhe në periudha të mëvonshme. ➤ Reflekton mbi pyetje të tilla si: “Çfarë ndryshoi?”, “Çfarë mbeti njësoj?”, “Për kë ishte ky ndryshim i rëndësishëm?”

	të gjitha ndryshimet ndodhin me të njëjtin ritëm dhe se ndikimi i tyre nuk është i njëjtë për të gjithë njerëzit apo grupet shoqërore. Nxënësi zhvillon gjithashtu aftësinë për të reflektuar mbi shkallën dhe ritmin e ndryshimit, duke vlerësuar nëse ato përfaqësojnë progres, për kë janë të rëndësishme dhe çfarë pasoja kanë sjellë në rrjedhën e historisë.	➤ Kupton që historia nuk zhvillohet gjithmonë me ritme të barabarta dhe se ndryshimet kanë ndikime të ndryshme për grupe të ndryshme njerëzish në kohë dhe hapësirë.
Diversiteti	Fjala “diversitet” nënkupton larminë dhe shumëllojshmërinë e përvojave, identiteteve, kulturave, mënyrave të të jetuarit dhe pikëpamjeve që kanë ekzistuar dhe bashkëjetuar brenda një grupi, shoqërie apo në marrëdhëniet midis popujve në kohë dhe hapësirë. Në histori, diversiteti shfaqet në forma të ndryshme, përfshirë: - Diversitetin kulturor, që përfshin gjuhët, zakonet, traditat, besimet, artet dhe mënyrat e të jetuarit të komuniteteve të ndryshme në kohëra të ndryshme. - Diversitetin etnik, që lidhet me përkatësitë popullore dhe kombëtare, origjinat historike dhe marrëdhëniet ndërmjet grupeve etnike brenda dhe ndërmjet shteteve. - Diversitetin fetar, që përfshin bashkëjetesën ose konfliktet ndërmjet besimeve dhe praktikave të ndryshme fetare në periudha të ndryshme historike.	Nxënësi: ➤ Kupton se njerëzit dhe shoqëritë në të njëjtën periudhë kohore kanë pasur përvoja të ndryshme për shkak të përkatësisë së tyre kulturore, etnike, fetare, gjinore apo sociale. ➤ Dallon mënyrat e bashkëjetesës, shkëmbimeve dhe konflikteve ndërmjet qytetërimeve apo komuniteteve me përkatësi të ndryshme në periudhën antike dhe mesjetare. ➤ Respekton larminë e kulturave, besimeve dhe zakoneve në kohë të ndryshme historike, duke zhvilluar ndjeshmëri ndërkulturore. ➤ Analizon rolin dhe përfaqësimin e grupeve të ndryshme në shoqëritë e së kaluarës, përfshirë gratë, fëmijët, pakicat dhe komunitetet e marginalizuara; ➤ Kupton se rolet gjinore dhe përfaqësimi i burrave dhe grave kanë qenë të ndryshëm sipas kohës dhe vendit, dhe reflekton mbi zhvillimin e barazisë gjinore në histori.

	- Diversitetin social dhe ekonomik, që pasqyron ndryshimet në klasë shoqërore, profesion, mënyra jetese, të drejta dhe akses në burime e pushtet. - Diversitetin e mendimit dhe përfaqësimit, që lidhet me pikëpamje të ndryshme për të njëjtat ngjarje historike, në varësi të pozitës, përkatësisë ose përvojës së individëve dhe grupeve. - Diversitetin gjinor, që nënkupton rolet, përvojat dhe kontributet e ndryshme të gjinive në histori, veçanërisht të grave, të cilat shpesh janë lënë jashtë rrëfimeve tradicionale historike. Ky aspekt ndihmon nxënësit të kuptojnë se konceptet e gjinisë dhe rolet shoqërore të burrit dhe gruas nuk kanë qenë statike, por kanë ndryshuar në kohë dhe në kontekste të ndryshme kulturore. - Përfshirja e diversitetit në mësimin e historisë ka një rol thelbësor në zhvillimin e mendimit kritik, respektit ndërkulturor dhe vetëdijes qytetare. Ky koncept ndihmon nxënësin të kuptojë se historia nuk është një zë i vetëm, por një bashkëjetesë perspektivash, shpesh të ndryshme ose kontradiktore, të cilat ndërtojnë kujtesën kolektive dhe identitetin tonë sot.	➤ Ndërton qëndrime gjithëpërfshirëse dhe qytetare, duke vlerësuar historinë si një bashkëjetesë përvojash dhe perspektivash të ndryshme.
Empatia historike	Empatia historike është aftësia për të kuptuar mendimet,	Nxënësi:

	ndjenjat, motivimet dhe veprimet e njerëzve që kanë jetuar në kohë dhe rrethana të ndryshme nga ato të sotmet. Ky koncept nuk ka të bëjë me të ndjerit keq apo me mëshirën ndaj figurave historike, por me përpjekjen për t'u vendosur në vendin e tyre, për të kuptuar botëkuptimin e tyre, mënyrën si ata e kanë perceptuar realitetin dhe si kanë marrë vendime në kontekstin e kohës ku kanë jetuar. Empatia historike kërkon që nxënësi të interpretojë burimet me kujdes, të analizojë kontekstin kulturor, politik dhe social të periudhës përkatëse dhe të shmangë gjykimet sipas standardeve të sotme. Kjo i ndihmon nxënësit të zhvillojnë një kuptim më të thelluar dhe të balancuar të së kaluarës, duke e parë atë jo si një listë faktesh apo datash, por si një seri përvojash njerëzore të ndërlikuara, të mbushura me zgjedhje, dilema dhe vështirësi. Empatia historike është një urë lidhëse midis të shkuarës dhe të tashmes. Ajo i ndihmon nxënësit të zhvillojnë mendim kritik, ndjeshmëri kulturore dhe të ndërtojnë qëndrime më të reflektuara dhe të përgjegjshme si qytetarë të një bote shumëdimensionale dhe ndërkulturore.	➤ Kupton se njerëzit në të kaluarën kanë jetuar në kushte dhe me vlera të ndryshme nga ato të sotmet dhe nuk mund të gjykohen me standardet e së tashmes. ➤ Kupton këndvështrimin e njerëzve të së kaluarës duke analizuar burimet historike, rrethanat dhe mënyrën si ata e përjetuan kohën e tyre. ➤ Reflekton mbi ndjenjat, motivimet dhe vendimet e figurave historike, duke treguar mirëkuptim për kompleksitetin e situatave që kanë përjetuar. ➤ Ndërton tregime ose skenarë historike ku përpiqet të rikrijojë perspektivat e ndryshme të personazheve të kohës. ➤ Diskuton ngjarje historike duke i shqyrtuar jo vetëm nga aspekti faktik, por edhe përmes përvojës njerëzore të atyre që i përjetuan; ➤ Shmang stereotipet, gjykimet e thjeshtuara dhe paragjykimet në trajtimin e grupeve apo individëve të së kaluarës.
Rëndësia historike	Koncepti i rëndësisë historike lidhet me vlerësimin e ndikimit që kanë pasur ngjarjet, njerëzit, idetë apo proceset historike në zhvillimin e shoqërisë në kohën kur kanë	Nxënësit:


	ndodhur dhe në ndikimin që ato kanë lënë në të tashmen. Të kuptosh rëndësinë e një ngjarjeje nuk do të thotë thjesht të përmendësh se ajo ka ndodhur, por të analizosh pse ajo është e rëndësishme, për kë, në çfarë kohe, dhe në çfarë mënyre ajo ka ndikuar në rrjedhën e mëtejshme të historisë. Vlerësimi i rëndësisë së ngjarjeve historike kërkon që nxënësi të identifikojë kriteret që përdoren për të gjykuar rëndësinë, si për shembull: ndikimi afatgjatë, përfshirja e shumë njerëzve, përmbysja e një rendi të mëparshëm apo trashëgimia që lë pas. Këto gjykime shpesh varen nga këndvështrimi i atij që i bën dhe nga koha kur bëhen. Kështu, ajo që mund të jetë konsideruar e rëndësishme në një kohë të caktuar mund të vlerësohet ndryshe në një periudhë tjetër. Mësimi i këtij koncepti ndihmon nxënësin të kuptojë se rëndësia është një mënyrë e të kuptuarit që varet nga interpretimi, dhe jo një e dhënë absolute, duke nxitur kështu aftësinë për të argumentuar, për të krahasuar dhe për të reflektuar mbi ndikimin e së kaluarës në të tashmen dhe të ardhmen.	➤ Kupton se jo të gjitha ngjarjet historike kanë të njëjtën peshë dhe se rëndësia e tyre varet nga ndikimi që kanë pasur në zhvillimet e mëvonshme. ➤ Analizon pse disa ngjarje, figura apo zhvillime historike janë konsideruar të rëndësishme në një kohë të caktuar dhe pse vlerësimi për to mund të ndryshojë me kalimin e kohës. ➤ Identifikon kritere për të vlerësuar rëndësinë e një ngjarjeje (si ndikimi afatgjatë, numri i njerëzve të përfshirë, pasojat, lidhja me të tashmen etj.). ➤ Krahason ndikimin e dy ose më shumë ngjarjeve për të vendosur se cila ka pasur më shumë ndikim në një periudhë të caktuar. ➤ Argumenton rëndësinë e një figure historike, duke u bazuar në të dhëna konkrete dhe në ndikimin që ajo ka pasur në jetën e njerëzve apo në zhvillimin e një qytetërimi. ➤ Reflekton mbi mënyrën si përshkruhen ngjarjet apo figurat në librat e historisë dhe diskuton nëse këto përshkrime pasqyrojnë një vlerësim objektiv apo të njëanshëm të rëndësisë së tyre.
--	---	---

5 PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Programi i historisë në arsimin e mesëm të ulët e ndihmon nxënësin që të kuptojë më mirë realitetin e sotëm dhe ngjarjet aktuale që ndodhin, duke i kuptuar ato në mënyrë kritike, për të bërë lidhjen e së sotmes me të shkuarën historike dhe me perspektivat e së ardhmes.

Diagrama 1. Korniza konceptuale e lëndës së historisë

- Historia e shqiptarëve
- Qytetërimet botërore



4.4 Koha mësimore për secilën tematikë për klasën e gjashtë

Lënda e historisë në klasën e gjashtë zhvillohet për 35 javë mësimore me nga 1 orë në javë, pra gjithsej 35 orë mësimore vjetore. Programi i historisë sugjeron peshën (*orët e sugjeruara*) për secilën tematikë. Shpërndarja e orëve ka për qëllim që përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në raport me orët totale vjetore.

Tabela 4. Shpërndarja e orëve mësimore, klasa VI

Tematika	Orë të sugjeruara
Tematika 1. Qytetërimet e hershme në Antikitë (mijëvjeçarët IV – II para erës sonë)	7
Tematika 2. Qytetërimet klasike në Mesdhe (shek. VIII para erës sonë – shek. V të erës sonë)	8
Tematika 3. Qytetërimet në mesjetën e hershme (shek. V – X)	5
Tematika 4. Zhvillimet politike dhe shoqërore në mesjetën e mesme (shek. XI – XIII)	7
Tematika 5. Evropa në mesjetën e vonë (shek. XIV – XV)	8
Totali i orëve	35

4.5 Përmbajtja e klasës së gjashtë

Në klasën e 6-të, përmbajtja e programit të lëndës “Histori” trajton evoluimin e qytetërimeve antike dhe historinë e qytetërimeve mesjetare, duke pasqyruar tipologjinë e këtij qytetërimi, i njohur ndryshe si “epoka e errët” e qytetërimit botëror. Programi ka për qëllim të shpjegojë etapat kryesore, nëpër të cilat ka kaluar zhvillimi i shoqërisë mesjetare dhe qytetërimet në mesjetë. Ai trajton mënyrat e jetesës, botën materiale, mënyrën e organizmit ekonomik, politik dhe kulturor, si dhe botën shpirtërore të këtyre qytetërimeve, për të kuptuar lidhjen midis këtyre qytetërimeve dhe

vazhdimësinë e tyre në të ardhmen. Nxënësit kuptojnë kalimin nga qytetërimet në lashtësi në qytetërimet mesjetare, duke dalluar lidhjen ndërmjet këtyre qytetërimeve.

KLASA E GJASHTË

4.5.1 Tematika: Qytetërimet e hershme në Antikit. (mijëvjeçarët IV – II para erës sonë)

PËRSHKRIMI I TEMATIKËS	
Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi lindjen dhe tiparet e qytetërimeve të hershme në Mesopotami dhe Egjipt. Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar edhe veprimtari praktike, të cilat jepen në rubrikën “Veprimtari të sugjeruara për tematikën”. Këto orë veprimtarish mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtaritë realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënësit gjatë gjithë jetës.	
KLASA 6 NJOHURITË	KLASA 6 REZULTATET E TË NXËNIT (Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës)
- Lindja e qytetërimeve në luginat lumore - Qytetërimi në Mesopotami - Qytetërimi egjiptian - Kultura dhe besimi në Mesopotami dhe Egjipt	Lindja e qytetërimeve në luginat lumore <i>Nxënësi:</i> - tregon në hartë vendndodhjen e qytetërimeve që lindën në brigjet e lumenjve (Mesopotami, Egjipt); - përcakton kohën e lindjes së qytetërimeve në Mesopotami dhe Egjipt; - vlerëson rolin e mjedisit gjeografik në lindjen dhe zhvillimin e qytetërimit (Mesopotami, Egjipt). Qytetërimi në Mesopotami

	<i>Nxënësi:</i> - përshkruan veçoritë e ndërtimin shoqëror në Mesopotami; - përshkruan veçoritë e zhvillimit ekonomik në Mesopotami; - tregon tiparet e organizimit shtetëror në Mesopotami; - tregon rolin e ligjeve të Hamurabit në zhvillimet ekonomike, shoqërore e politike në Mesopotami. Qytetërimi egjiptian <i>Nxënësi:</i> - përshkruan veçoritë e ndërtimin shoqëror në Egjipt; - përshkruan veçoritë e zhvillimit ekonomik në Egjipt; - tregon tiparet e organizimit shtetëror në Egjipt. Kultura dhe besimi në Mesopotami dhe Egjipt <i>Nxënësi:</i> - shpjegon kulturën materiale e shpirtërore të qytetërimeve në Mesopotami dhe Egjipt; - dallon karakteristikat e përbashkëta dhe të veçantat ndërmjet dy kulturave; - vlerëson rolin e arritjeve të këtyre qytetërimeve në jetën e sotme; - njeh dhe vlerëson disa nga figurat historike që i përkasin kësaj tematike, si: sargoni, hammurabi, menes, ramsesi etj.
KONCEPTE DHE TERMA Gjysmëhëna e begatë; mbeturina lumore; kode; faraon; shpikje; shkrimi, llojet e tij; politeizëm; piramida; mumie; tuma; etnosi ilir.	

VEPRIMTARI TË SUGJERUARA PËR TEMATIKËN “QYTETËRIMET E HERSHME NË ANTIKITET. (MIJËVJEÇARËT IV – II PARA ERËS SONË)”

Linja e kohës

- Ndërton një linjë të thjeshtë kronologjike për të paraqitur periudhat parahistorike dhe historike.
- Vendos ngjarje kyçe në këtë linjë (si lindja e qytetërimeve në Egjipt dhe Mesopotami).
- Zbaton njohuritë matematikore në llogaritjen e kohës dhe kryen veprime për llogaritjen e kohës para dhe pas erës sonë.

Kultura e re e epokës së bronzit, ndryshime në jetën shoqërore, kulturore dhe shpirtërore

- Përcakton popullsinë para-ilire si pararendëse e kulturës së bronzit.
- Identifikon dhe vendos në hartë vendbanime të njohura të periudhës së bronzit në territorin shqiptar (si tumat në Mat, Kukës, Korçë etj.).
- Përshkruan elemente të kulturës materiale (vegla, strehimi, objektet prej balte ose metali) dhe të botës shpirtërore (kulti i të vdekurve, besimet, ritualet) të kësaj popullsie.
- Krijon një mini-ekspozitë me vizatime ose postera, që tregojnë jetën e përditshme të njerëzve të asaj kohe dhe lidhjet me historinë e Shqipërisë.

Ekspozitë: “Trashëgimia e qytetërimeve të hershme”

- Vlerëson elemente të identitetit, trashëgimisë dhe ndikimeve ndërkulturore në qytetërimet e Mesopotamisë dhe Egjiptit (si ligjet, piramidat, alfabeti, arti, arkitektura).
- Shkruan një mesazh të shkurtër përse është e rëndësishme të duam vendin tonë dhe të ruajmë gjërat e çmuara nga e kaluara.
- Përshkruan vështirësitë dhe sfidat me të cilat përballeshin qytetërimet e hershme (si përmytjet, thatësitat, luftërat) dhe tregon mënyrat se si ata reagonin dhe i zgjidhnin ato.

- Krijon një poster me titullin: “Çfarë mund të mësojmë nga qytetërimet e hershme për t’u përballur me problemet e sotme?”, duke bërë krahasime me sfida aktuale si ndryshimet klimatike, pandemitë apo krizat globale.
- Krijon një foto-album me temën: “Nga shpikjet e para të teknologjia e sotme”, duke vendosur foto të shpikjeve të rëndësishme të Mesopotamisë dhe Egjiptit (si: rrota, ujitja, matematika, kalendari) dhe shpjegon si ndihmojnë ato edhe sot.

4.5.2 Tematika: Qytetërimet klasike në Mesdhe. (shek. VIII para erës sonë – shek. V të erës sonë)

PËRSHKRIMI I TEMATIKËS	
Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi lindjen dhe përhapjen e qytetërimeve në brigjet e deteve të Mesdheut. Tematika trajton qytetërimin grek, shtetin, shoqërinë dhe jetën e përditshme në qytetërimin antik grek, artin, kulturën shkencën dhe besimin në këtë qytetërim. Tematika trajton, gjithashtu, qytetërimin romak, shtetin, shoqërinë dhe jetën e përditshme në këtë qytetërim, artin, kulturën dhe shkencën në qytetërimin romak, si dhe përhapjen e tyre. Nëpërmjet kësaj tematike, nxënësit mësojnë për ndërprerjen graduale të qytetërimeve antike në Evropë dhe kalimin drejt qytetërimeve mesjetare, si dhe për popujt që migruan në territorin e Perandorisë Romake. Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar edhe veprimtari praktike cilat jepen në rubrikën “Veprimtari të sugjeruara për tematikën”. Këto orë veprimtarish mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtaritë realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënësit gjatë gjithë jetës.	
KLASA 6 NJOHURITË	KLASA 6 REZULTATET E TË NXËNIT (Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës)
- Lindja dhe përhapja e qytetërimeve antike të Mesdhe të Mesdheut	Lindja dhe përhapja e qytetërimeve antike të Mesdheut <i>Nxënësi:</i>

- Qytetërimi grek - Qytetërimi romak - Perandoria Romake (fundi i shekullit I para erës sonë – fundi i shekullit V pas erës sonë)	- tregon në hartë vendosjen dhe shtrirjen e qytetërimeve antike të mesdheut, qytetërimit fenikas dhe hebraik; - identifikon faktorët e zhvillimit të qytetërimeve në brigjet e detit Mesdhe. Qytetërimi grek <i>Nxënësi:</i> - tregon tiparet e organizimit shoqëror në qytetërimin grek; - dallon nëpërmjet ilustrimeve elemente të jetës së përditshme; - përshkruan evolucionin politik të qytet-shteteve greke të Athinës dhe të Spartës; - tregon në hartë përhapjen e ngulimeve greke; - vlerëson rolin e demokracisë antike në zhvillimin e qytetërimin grek dhe qytetërimeve të mëvonshme; - përshkruan tiparet e artit, kulturës, besimit, shkencës dhe të arsimit në qytetërimin grek; Qytetërimi romak <i>Nxënësi:</i> - përcakton kohën e lindjes së qytetërimit romak; - përshkruan tiparet e organizimit shoqëror të qytetërimit romak; - tregon aspekte të jetës së përditshme të jetës romake; - përshkruan evolucionin politik të Romës; - dallon krijimin e së drejtës romake, si një prej legjislacioneve më të rëndësishme të jurisprudencës botërore;
---	--

	- përshkruan tiparet e artit, kulturës, besimit, shkencës dhe arsimit në qytetërimin romak. Perandoria Romake (fondi i shekullit I para erës sonë – fondi i shekullit V pas erës sonë) <i>Nxënësi:</i> - përshkruan kushtet e lindjes së krishterimit, duke evidentuar rrethanat historike të kalimit nga besimi pagan në atë të krishterë; - liston faktorët historikë që ndikuan në përhapjen e krishterimit; - përshkruan faktorët historikë që shkaktuan lëvizjen e popujve; - tregon në hartë “dyndjen e popujve” në Evropë; - tregon pasojat që sollën migrimet e popujve në Evropë; - dallon rolin e migrameve të popujve si faktor kyç në lindjen e qytetërimit mesjetar; - njeh dhe vlerëson disa nga figurat historike që i përkasin kësaj tematike, si: Minos, Homeri, Solon, Klisteni, Perikliu, Jul Cezari, Oktaviani, Spartaku, Romuli, Atila, Teodoriku, Aleksandri i Madh etj.
KONCEPTE DHE TERMA Popuj të detit; fenikas; hebraik, mure ciklopike; qytet-shtet; koloni; oligarki; demokraci; tirani; patric; plebenj; skllevër; skllavopronar; gladiator; perandori; stil dorik; stil jonik; stil korintik; hark triumfi; obelisk; monoteizëm; letërsi; filozofi; art; arkitekturë; kristianizëm; dyndje (migrim); krizë; shtete romane-gjermanike.	
VEPRIMTARI TË SUGJERUARA PËR TEMATIKËN “QYTETËRIMET KLASIKE NË MESDHE (SHEK. VIII PARA ERËS SONË – SHEK. V TË ERËS SONË)”	

Në gjurmët e qytetërimeve klasike

- Shpjegon si funksiononte demokracia në Athinë dhe e krahason me mënyrën si votohet sot.
- Diskuton në grup se si ndihmoi demokracia e lashtë në ndërtimin e shteteve demokratike sot.
- Tregon për disa elementë të trashëgimisë greke dhe romake që janë ende të pranishëm edhe sot (arkitekturë, ligje, shkrime, arte, sporte, kalendari, rrugët, etj.).
- Diskuton në grup se si kanë ndikuar luftërat, krizat dhe migrimet në ndryshimet që ndodhin në botë.
- Krijon në grup një poster të thjeshtë me temën: “Dyndjet e popujve dhe migrimet sot – çfarë mësimesh marrim?”
- Diskuton sesi ndarjet dhe ndryshimet e mëdha historike (si fundi i Romës) sollën fillime të reja për botën.
- Krijon në grup një poster ose prezantim me titullin: “Shpikjet greko-romake që përdorim edhe sot” (ujësjellësit, rrugët, mekanizmat, mjetet e matjes etj.).

Qytetërimet e hershme në Ballkan – Qytetërimi Ilir

- Tregon në hartë ku jetonin fiset më të njohura ilire.
- Përshkruan si ishte jeta e përditshme në Iliri (si visheshin, çfarë hanin, çfarë besonin) dhe e krahason me disa zakone shqiptare që ruhen edhe sot.
- Diskuton në klasë: Pse është e rëndësishme të ruajmë trashëgiminë kulturore?
- Shpjegon si ndikuan grekët dhe romakët te ilirët në mënyrën e jetesës, në ndërtim apo në besime.
- Diskuton si arritën ilirët të ruajnë identitetin e tyre, edhe kur hasën vështirësi.

Romanizimi dhe Ilirët

- Shpjegon çfarë është romanizimi dhe si ndodhi në trojet ilire.

- Diskuton me grupin: Si mund ta ruajmë gjuhën dhe kulturën tonë edhe sot, kur jetojmë në një botë të madhe e të ndryshme?
- Tregon emrat e disa perandorëve romakë me origjinë ilire dhe përse janë të rëndësishëm për ne.
- Përgatit një poster të thjeshtë me foto dhe vizatime për teknologjitë që sollën romakët në Iliri (si rrugët, ujësjellësit, urat etj.).

4.5.3 Tematika: Qytetërimet në mesjetën e hershme (shek. V – X)

PËRSHKRIMI I TEMATIKËS	
Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi krijimin e Perandorisë Bizantine si vazhdim i qytetërimeve greko-romake, ardhjen e sllavëve në Ballkan e Bizant, tiparet e qytetërimit bizantin, si: organizimin shtetëror, ekonomik, kulturor dhe fetar, si dhe tiparet e qytetërimit arab, përfshirë dhe organizimin shoqëror, ekonomik dhe kulturor. Gjithashtu, ata mësojnë rreth kushteve historike të lindjes së besimit islam, përhapjes dhe veçorive të tij. Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar edhe veprimtari praktike të cilat jepen në rubrikën “Veprimtari të sugjeruara për tematikën”. Këto orë veprimtarish mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtaritë realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënësit gjatë gjithë jetës.	
KLASA 6 NJOHURITË	KLASA 6 REZULTATET E TË NXËNIT (Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës)
- Qytetërimi bizantin - Organizimi i Perandorisë Bizantine - Qytetërimi arab dhe Europa	Qytetërimi bizantin <i>Nxënësi:</i> - përcakton në hartë vendndodhjen e Perandorisë Bizantine; - dallon shkaqet e krijimit të Perandorisë Bizantine; - përshkruan tiparet e qytetërimit bizantin;

	- përcakton në hartë lëvizjet e sllavëve në Ballkan e Bizant; - tregon pasojat e dyndjeve sllave në Ballkan. Organizimi i Perandorisë Bizantine <i>Nxënësi:</i> - përshkruan tiparet e organizimit shtetëror dhe shoqëror në qytetërimin bizantin; - vlerëson arritjet e këtij qytetërimi në art, kulturë dhe arsim; - shpjegon karakterin dhe rolin e kodit të justinianit në zhvillimet ekonomike, shoqërore e politike në qytetërimin bizantin dhe atij evropian; - dallon shkaqet e ndarjes së kishës kristiane. Qytetërimi arab dhe Evropa <i>Nxënësi:</i> - tregon kushtet historike të lindjes dhe përhapjes së besimit islam; - përshkruan veçoritë e qytetërimit arab; - tregon në hartë shtrirjen e kalifatit arab; - vlerëson arritjet e qytetërimit arab në art, kulturë dhe shkencë dhe ndikimin e tij në Evropë; - njeh dhe vlerëson disa nga figurat historike që i përkasin kësaj tematike, si: Justiniani, Muhamedi, Omar Kahjan, Avicena etj.
KONCEPTET DHE TERMAT Trashëgimi greko-romake; sllavizëm; asimilim; ndarja e kishës; perandori; krishtërim i ritit perëndimor (katolicizëm); krishtërim i ritit lindor (ortodoksi); periodizimi i epokës mesjetare, kod i Justininit; islam; kalifat.	

VEPRIMTARI TË SUGJERUARA PËR TEMATIKËN “QYTETËRIMET NË MESJETËN E HERSHME” (SHEK. V – X)

Bizanti, trashëgimi nga lashtësia

- Tregon në hartë ku ndodhej Perandoria Bizantine dhe qyteti i Kostandinopojës.
- Përshkruan disa arritje të bizantinëve në art, shkolla, fe dhe ndërtim (p.sh. mozaikët, kishat me kupola, shkollat).
- Diskuton me klasën pse disa gjëra të bizantinëve janë ende sot pjesë e kulturës sonë (si ikonat ose arkitektura kishtare).
- Vizaton ose ngjit fotografi në një fletë pune me titullin: “Bizanti në gjurmët tona – çfarë kemi trashëguar?” (p.sh. një kishë e stilit bizantin, një mozaik, një libër i vjetër kishtar etj.).

Gjurmë bizantine në trojet arbërore

- Tregon në hartë disa nga vendet ku janë gjetur vepra me ndikim bizantin në territorin e Shqipërisë (p.sh. Apollonia, Durrësi, Butrinti, kisha e Rubikut, mozaikët e Linit).
- Përshkruan disa elementë të arkitekturës, artit ose besimit që janë trashëguar nga periudha bizantine në Shqipëri (p.sh. mozaikët, katedralet e hershme, përdorimi i ikonave).
- Përgatit një poster të thjeshtë me titullin: “*Bizanti në Shqipëri, trashëgimia që jeton*”, ku përfshin 2-3 shembuj konkretë (vizatim, fotografi, përshkrim të shkurtër).

Zbulime të qytetërimit arab që i përdorim edhe sot

- Tregon në hartë ku u përhap qytetërimi arab dhe ku jetuan disa dijetarë të njohur.
- Përcakton disa zbulime të rëndësishme të qytetërimit arab, si: numrat, mjekësia, harta, librat, teleskopi.
- Diskuton në klasë: “Si do ishte jeta jonë pa këto shpikje?”

- Përgatit një fletë-posteri ku shkruan 3 shpikje të qytetërimi arab dhe vizaton ose ngjit një foto për secilën.

4.5.4 Tematika: Zhvillimet politike dhe shoqërore në mesjetën e mesme (shek. XI – XIII)

PËRSHKRIMI I TEMATIKËS

Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi feudalizmin si një sistem i ri, tiparet themelore të këtij sistemi: aristokracinë, vasalitetin, bujkrobërinë. Tematika trajton lindjen e qyteteve, zhvillimin e tregtisë, ndryshimin në strukturën shoqërore dhe në mënyrën e jetesës, si dhe marrëdhëniet midis dy qytetërimeve: perëndimor dhe lindor; kryqëzatat, marrëdhëniet tregtare.

Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar edhe veprimtari praktike të cilat jepen në rubrikën “Veprimtari të sugjeruara për tematikën”. Këto orë veprimtarish mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtaritë realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënësit gjatë gjithë jetës.

KLASA 6 NJOHURITË	KLASA 6 REZULTATET E TË NXËNIT <i>(Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës)</i>
- Ndryshimet në qytetërimet mesjetare evropiane - Marrëdhëniet midis dy qytetërimeve, perëndimor dhe lindor	Ndryshimet në qytetërimet mesjetare evropiane <i>Nxënësi:</i> - shpjegon tiparet themelore të sistemit feudal; - dallon ndryshimet e këtij sistemi në jetën ekonomike dhe shoqërore; - përshkruan detyrimet e shtresave shoqërore ndaj njëra-tjetrës; - tregon faktorët që çuan në lindjen e qyteteve mesjetare; - përshkruan një qytet mesjetar;

	- vlerëson rolin e zejeve dhe tregtisë në zhvillimin e qytetit mesjetar; - përcakton strukturën shoqërore të Evropës mesjetare; - krahason mënyrën e jetesës së shoqërisë në Evropën mesjetare; - evidenton tiparet e artit, kulturës, arsimit dhe besimit fetar në qytetet mesjetare. Marrëdhëniet midis dy qytetërimeve, perëndimor dhe lindor <i>Nxënësi:</i> - përshkruan marrëdhëniet midis qytetërimit arab dhe atij evropian; - përkufizon termin kryqëzatë; - shpjegon shkaqet e fillimit të kryqëzatave; - evidenton pasojat e kryqëzatave në marrëdhëniet mes dy qytetërimeve; - vlerëson disa nga figurat historike që i përkasin kësaj tematike, si: Papa Urbani II, Saladini, Dhimitri i Arbrit, etj.
KONCEPTE DHE TERMA Feudalizëm; fisnikëri; vasalitet; bujkrobëri; vasal; detyrim; qytete; konflikte; shtresa shoqërore; çiflig; arkond; kështjellë; korporatë; esnafe; çirak; punë me mëditje; kryqëzatë.	
VEPRIMTARI TË SUGJERUARA PËR TEMATIKËN “ZHVILLIMET POLITIKE DHE SHOQËRORE NË MESJETËN E MESME (SHEK. XI – XIII)” Udhëtim në qytetet mesjetare - Përshkruan një qytet mesjetar duke përfshirë: rrugët, tregun, zejtarët, kishën, kështjellën dhe jetën e përditshme të banorëve. - Ndërton një model 3D ose poster me elementët kryesorë të një qyteti mesjetar dhe i shpjegon në mënyrë të thjeshtë ato.	

- Diskuton ndryshimet që solli zhvillimi i qyteteve: si ndryshoi jeta e njerëzve dhe si u zhvilluan tregtia dhe zejet.
- Krahason jetën në qytet dhe në fshat gjatë mesjetës duke dhënë disa shembuj praktikë.

Arbërit në Mesjetë

- Shpjegon se si ishte organizuar jeta në territoret arbërore gjatë shek. XI–XIII (fiset, fisnikëria, kështjellat, marrëdhëniet shoqërore).
- Gjen në hartë disa nga qendrat e njohura të asaj kohe, si Kruja, Shkodra, Berat, dhe shkruan 2–3 fakte historike për secilën prej tyre.
- Liston disa simbole të rëndësishme të kulturës arbërore mesjetare: flamuri, mburoja, ndërtimet, veshjet tradicionale, monedhat.
- Përshkruan një figurë historike shqiptare të periudhës mesjetare (p.sh. Gjergj Kastrioti, Gjon Muzaka, Dhimitër Progoni) dhe vlerëson kontributin e tij në historinë e Shqipërisë.
- Përgatit një poster ose fletë informuese me titullin: *“Arbërit në Mesjetë – Jeta, Veshjet dhe Simbolet”*, ku paraqet aspekte të jetës së përditshme, , si pamje të veshjeve tradicionale, simbole përfaqësuese etj

4.5.5 Tematika: Evropa në mesjetën e vonë (shek. XIV – XV)

PËRSHKRIMI I TEMATIKËS

Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi procesin e lindjes së shtet-kombeve: nga copëtimi feudal te mbretëritë e përqendruara, veçoritë e këtij procesi në Evropën perëndimore. Tematika trajton Mbretërinë e Anglisë, atdheun e parlamentarizmit; kalimin nga monarkia absolute në atë kushtetuese: marrëdhëniet midis mbretërve dhe princërve në Angli; lindjen e parlamentarizmit në Angli dhe ndikimin e tij në zhvillimet e mëvonshme historike. Nëpërmjet kësaj tematike, nxënësit kuptojnë rëndësinë që pati Karta e Madhe e Lirive si fillesë historike e demokracisë parlamentare.

Tematika zhvillon modelin klasik të monarkisë absolute në Francë, copëtimin feudal të saj, hapat e forcimit të monarkisë franceze, karakterin e absolutizmit francez. Nëpërmjet kësaj tematike, nxënësit aftësohen dhe për organizimin politik ekonomik dhe shoqëror të Perandorisë Osmane,

zhvillimin e arsimit, artit, kulturës, shkencës në mesjetë. Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar edhe veprimtari praktike të cilat jepen në rubrikën “Veprimtari të sugjeruara për tematikën”. Këto orë veprimtarish mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtaritë realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënësit gjatë gjithë jetës.

KLASA 6 NJOHURITË	KLASA 6 REZULTATET E TË NXËNIT <i>(Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës)</i>
- Fillesat e shtet-kombeve - Mbretëria e Anglisë - Monarkia franceze - Perandoria Osmane - Kultura dhe besimi në qytetërimet mesjetare	Fillesat e shtet-kombeve <i>Nxënësi:</i> - përkufizon konceptin shtet-komb; - tregon shtet-kombet në hartën e Evropës mesjetare; - përshkruan procesin e kalimit nga copëtimi feudal në shtet-kombe; - dallon veçoritë e procesit të krijimit të shtet-kombeve, në Evropën Perëndimore; - përshkruan karakteristikat e sistemit politik të Evropës Perëndimore, duke evidentuar forcimin e pushtetit mbretëror. Mbretëria e Anglisë <i>Nxënësi:</i> - përshkruan marrëdhëniet midis princërve dhe mbretërve në Angli; - vlerëson ndarjen e pushtetit të mbretit nga parlamenti; - vlerëson rolin e kartës së madhe të lirive në respektimin e të drejtave humane; Monarkia franceze <i>Nxënësi:</i>

	- shpjegon marrëdhëniet hierarkike midis feudalëve dhe mbretërve në Francë; - përshkruan etapat e zhvillimit të mbretërisë franceze. - dallon ndryshimet ndërmjet monarkisë Franceze dhe angleze. Perandoria Osmane <i>Nxënësi:</i> - tregon lidhjen midis selxhukëve dhe osmanëve; - përshkruan kushtet historike të formimit të Perandorisë Osmane; - përshkruan rrugën e krijimit të shtetit osman; - tregon organizimin politik dhe shoqëror të perandorisë osmane. Kultura dhe besimi në qytetërimin mesjetar <i>Nxënësi:</i> - evidenton tiparet e zhvillimit të artit, kulturës, arsimit në qytetërimet mesjetare; - dallon rolin e fesë në qytetërimet mesjetare; - krahason tiparet e zhvillimit të artit dhe të kulturës në qytetërimin arab dhe atë perëndimor; - ndërton linjën e kohës për periudhën mesjetare; - njeh dhe vlerëson disa nga figurat historike që i përkasin kësaj tematike, si: Henri II, Henri VII, Mbreti Xhon, Uat Tajler, Eduardi i Anglisë, Huniadi, Mehmeti II, Llazari, Skënderbeu etj.
KONCEPTET DHE TERMAT	

Shtet-komb; Karta e Madhe e Lirive; parlamentarizëm; monarki absolute; monarki kushtetuese; republikë; selxhuk; sulltan; spahi; kaza; nahije; vilajet; pasha; sanxhak; kadi; dukat; Kuvendi i Lezhës.

VEPRIMTARI TË SUGJERUARA PËR TEMATIKËN “EVROPA NË MESJETËN E VONË (SHEK. XIV – XV)”

Skënderbeu heroi ynë kombëtar

- Tregon në hartë vendndodhjen e Principatës së Kastriotëve dhe përcakton qytetet kryesore që u përfshinë në luftën kundër Perandorisë Osmane.
- Përshkruan jetën dhe veprimtarinë e Gjergj Kastriot Skënderbeut: origjinën, betejat, rolin në Kuvendin e Lezhës dhe rëndësinë e tij në mbrojtjen e tokave shqiptare.
- analizon fragmente të shkurtra nga burime historike ose tekste letrare për Skënderbeun dhe diskuton domethënien e tyre.
- Krahason figurën e Skënderbeut me figura të rëndësishme të Evropës së Mesjetës së Vonë për të vlerësuar rolin e tij në nivel evropian.

Murtaja e Zezë – Pandemia që tronditi Mesjetën

- Shpjegon çfarë ishte Murtaja e Zezë, si u përhap dhe çfarë pasoja pati në popullsi, ekonomi dhe jetë shoqërore në Evropën e shek. XIV.
- Gjen në hartë rrugët e përhapjes së murtajës dhe qytetet ku ajo pati ndikim të madh.
- Përgatit një poster informues me titullin: “Si ndryshoi Evropa nga një pandemi”, ku paraqet fakte, shifra dhe dëshmi vizuale (dorëshkrime, ilustrime mesjetare, etj.).
- Krahason efektet e pandemisë së mesjetës me pandeminë COVID-19, duke analizuar ndryshimet dhe ngjashmëritë.

4.6 Qëndrime dhe vlera

Në lëndën e historisë nxënësi demonstroi qëndrimet dhe vlerat të përmbledhura si më poshtë:

- Shfaq interes dhe kuriozitet të vazhdueshëm për historinë si dije dhe si mënyrë për të kuptuar botën.
- Vlerëson rëndësinë e kërkimit historik dhe tregon përkushtim për të eksploruar burime dhe ngjarje.
- Mbështet përdorimin e mendimit kritik gjatë përballjes me burime dhe demonstroi dëshirë për të kuptuar më shumë.
- Pranon rëndësinë e dallimit mes fakteve dhe opinionit dhe respekton saktësinë e informacionit historik.
- Çmon rolin e burimeve historike në ndërtimin e një pasqyre objektive të së kaluarës.
- Vlerëson historinë si udhërrëfyes për të kuptuar të tashmen dhe për të ndërtuar të ardhmen.
- Tregon vlerësim për ndikimin e mjedisit gjeografik në zhvillimin e qytetërimeve të lashta.
- Çmon arritjet e qytetërimeve antike dhe mesjetare në fusha si arti, arsimi dhe kultura, si dhe ndikimin e tyre në botën moderne.
- Respekton trashëgiminë e së Drejtës Romake dhe e konsideron themel të sistemeve moderne ligjore.
- Vlerëson pozitën dhe trashëgiminë e qytetërimit shqiptar në kontekstin e historisë botërore.
- Shpreh mirënjohje dhe vlerësim për figurat historike që kanë ndikuar në zhvillimin e shoqërisë dhe identitetit kombëtar.
- Forcon ndjenjën e përkatësisë dhe krenarisë për identitetin kombëtar dhe e lidh atë me respektin për historinë kombëtare.
- Vlerëson trashëgiminë kulturore botërore si pasuri të përbashkët dhe si mjet për dialog ndërkulturor.
- Respekton larminë etnike dhe kulturore të shoqërisë dhe shfaq gatishmëri për të bashkëjetuar me dallimet.
- Shpreh krenari për vendin e tij/saj dhe njeh vlerat që sjellin kulturat e tjera në shoqëri.
- Pranon ekzistencën e interpretimeve të ndryshme historike dhe reflekton mbi shkaqet që i shkaktojnë ato.
- Respekton mendimet e ndryshme dhe demonstroi ndershmëri intelektuale në përdorimin e informacionit.
- Shpreh lirisht mendimet dhe mbështet kreativitetin si pjesë të të nxënies historike.
- Tregon paanësi dhe drejtësi në mënyrën si i kupton dhe i interpreton ngjarjet historike.

- Pranon kritikën me qëndrueshmëri dhe i përdor ato për përmirësim personal dhe akademik.
- Dëshmon pavarësi dhe vetëbesim në procesin e të nxënësve historik.
- Respekton përpjekjet dhe sukseset e të tjerëve dhe bashkëpunon me përgjegjësi në punën në grup.

4.6.1 Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e rezultateve të të nxënësve (RN-ve)

Në këtë rubrikë paraqiten disa shembuj të veprimtarive që mund të përdoren nga mësuesi për përmbushjen e rezultateve të të nxënësve në tematikën të ndryshme.

Tabela 3. Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e RN-ve

Rezultat të nxënësve të orës mësimore	Shembuj të veprimtarive praktike
Shembulli 1. Jeta dhe veprimtaria e Gjergj Kastriot Skënderbeut. <i>Nxënësi:</i> - diskuton për jetën dhe origjinën e Gjergj Kastriot Skënderbeut; - vlerëson rolin e tij si hero kombëtar;	Shembulli 1. <i>Prezantimi i situatës.</i> “Vendoseni veten në rolin e një të riu që jeton në një qytet të vogël të Arbërisë gjatë shekullit XV. Një ditë, merrni lajmin se Skënderbeu ka fituar një tjetër betejë kundër Perandorisë Osmane. Si do ta përshkruanit këtë ngjarje në një rrëfim që do të përcillej brezave të ardhshëm? Çfarë do të zgjidhnit të theksonit për jetën, origjinën dhe veprën e tij?” <i>Ndarja e roleve</i> Nxënësve u ndahen kartela me skenarë të ndryshëm, secila duke përfshirë një aspekt të ndryshëm nga jeta dhe veprimtaria e Skënderbeut, si:

- vlerëson jehonën e veprës së Skënderbeut në artin dhe kulturën botërore.	- Origjina e tij dhe fëmijëria në Krujë - Momentet e para të kthimit në atdhe dhe shpallja e qëndresës - Një betejë e fituar ndaj ushtrisë osmane - Takimi me Papa Piu II ose me princat e tjerë të Evropës - Jehona e figurës së tij në veprat artistike ose në kulturën botërore <i>Shkrimi dhe prezantimi</i> ✎ Çdo nxënës zgjedh një kartelë me një ngjarje ose betejë të kohës së Skënderbeut dhe përgatit një mini-rrëfim historik me 4–5 fjali, sikur të ishte dëshmitar i asaj kohe. Nxënësi shkruan mini-rrëfimin në fletoren e vet ose në një fletë poster të vogël. Më pas, e lexon me zë përpara klasës duke filluar, për shembull, kështu: <i>“Unë jam një banor nga qyteti i Krujës. Sot, më 1450, mora lajmin se Skënderbeu ka mbrojtur për të tretën herë qytetin tonë. Ai udhëhoqi 10,000 luftëtarë kundër një ushtrie shumë më të madhe osmane. Të gjithë jemi krenarë për të. E quajmë Atin e Arbërisë.”</i> <i>Reflektimi</i> Mësuesi nxit nxënësit të reflektojnë me këto pyetje: - “Çfarë e bën një person të quhet hero kombëtar?” - “Cilat janë vlerat që përfaqëson Skënderbeu në ditët e sotme?” - “Pse është e rëndësishme të ruajmë kujtesën historike përmes artit dhe shkrimeve?”
--	--

	- “Si e ndihmon historia edukimin për qytetarinë?”
Lidhja e shqiptarëve me qytetërimet evropiane të shek. XV. <i>Nxënësi:</i> - kërkon, grumbullon, përzgjedh materiale, duke evidentuar - lidhjen e shqiptarëve me qytetërimet evropiane të shek. XV.	Shembull 2 <i>Qëllimi i veprimtarisë</i> Të nxisë kërkimin aktiv dhe përzgjedhjen e informacionit nga burime të ndryshme për të zbuluar dhe reflektuar mbi mënyrat se si shqiptarët kanë qenë pjesë e rrjedhave të qytetërimit evropian në shekullin XV. <i>Prezantimi i situatës</i> “Imagjinoni se jeni studiues të rinj të historisë dhe po merrni pjesë në një ekspozitë për Evropën e shekullit XV. Detyra juaj është të grumbulloni dhe përzgjidhni të dhëna që tregojnë se si shqiptarët, nëpërmjet luftës, aleancave, artit dhe diplomacisë, kanë qenë të lidhur me qytetërimin evropian të kohës.” <i>Ndarja e roleve</i> Nxënësit u ndahen karta kërkimi me temat e mëposhtme, të cilat mund të jenë reale ose të bazuara në burime të përzgjedhura: - Aleanca e Skënderbeut me princat italianë dhe Papa Piu II - Letra dhe komunikimet diplomatike me Mbretërinë e Napolit - Përmendja e Skënderbeut në veprat e Marin Barletit, Fan Nolit, apo autorëve evropianë - Përfshirja e shqiptarëve në mbrojtjen e qytetërimit të krishterë nga pushtimet osmane - Ndikimi i luftës së shqiptarëve në politikën e jashtme të shteteve italiane dhe evropiane

	Çdo nxënës ose grup zgjedh një kartë dhe ka 15 minuta për të kërkuar (në libra të përgatitur, në fletë informuese ose burime të shtypura nga mësuesi) materiale që i përgjigjen pyetjes: - “Si shfaqet lidhja e shqiptarëve me qytetërimet evropiane të shek. XV në këtë kontekst?” <i>Përgatitja dhe prezantimi i fakteve</i> Nxënësit shkruajnë në fletët e tyre 3–4 fakte ose përfundime që kanë arritur nga materiali që kanë shqyrtuar. Më pas, prezantojnë para klasës, p.sh.: “Nga letra e Skënderbeut drejtuar Papës, kuptojmë se ai e konsideronte veten pjesë të botës së krishterë evropiane dhe kërkonte ndihmë nga vendet perëndimore për të ndaluar përparimin osman.” <i>Reflektimi</i> <i>Mësuesi nxit nxënësit me pyetje si:</i> - “Si ndihmonte Skënderbeu në mbrojtjen e Evropës nga pushtimet?” - “Çfarë tregojnë këto burime për vendin e shqiptarëve në hartën politike dhe kulturore të Evropës së shek. XV?” - “Pse është e rëndësishme të kuptojmë këto lidhje sot?”
--	--

Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e historisë do të përshkruhen veprimtari praktike për përmbushjen e rezultateve të të nxënës sipas tematikave të lëndës.

5 METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Mësimdhënia e historisë në arsimin e mesëm të ulët synon të ndihmojë nxënësit të shkojnë përtej riprodhimit të fakteve dhe datave, duke ndërtuar kuptime të thelluara për zhvillimet historike dhe lidhjet mes së shkuarës dhe së tashmes. Historia nuk është thjesht një përmbledhje ngjarjesh, por një mënyrë për të kuptuar shoqërinë, identitetin dhe ndryshimet në kohë. Ajo shërben si një mjet për të formuar qytetarë të ndërgjegjshëm, kritikë dhe të ndjeshëm ndaj vlerave demokratike dhe njerëzore.

Mësimdhënia synon të zhvillojë kompetencat e lëndës, *përfshirë aftësinë për kërkim historik, përdorimin e burimeve, analizën shkak-pasojë, interpretimin dhe shpjegimin e ngjarjeve historike, si dhe komunikimin e argumentuar të të kaluarës*. Po ashtu, *theksohet ndërtimi i koncepteve kyçe historike, si: kuptimi kronologjik, ndryshimi dhe vazhdimësia, diversiteti, empatia historike dhe rëndësia historike*. Përmes këtyre komponentëve, nxënësit mësojnë jo vetëm për ngjarjet, por edhe për mënyrat se si ato kanë ndikuar dhe vazhdojnë të ndikojnë në realitetin e sotëm. *Të nxënit aktiv dhe kërkimor bazuar në zhvillimin e kompetencave*. Nxënësit përfshihen në mënyrë aktive në procesin mësimor përmes analizës së burimeve historike, diskutimeve, ndërtimit të kohështirjeve, hartave dhe projekteve kërkimore që nxisin mendimin kritik dhe ndërveprimin me informacionin historik.

Përmes pyetjeve thelbësore dhe situatave problemore, nxënësit stimulojnë aftësinë për të analizuar, krahasuar dhe interpretuar ngjarje nga e kaluara, duke ndërtuar qëndrime të reflektuara për çështje me rëndësi shoqërore dhe njerëzore.

Argumentimi dhe komunikimi historik. Përdorimi i gjuhës së saktë historike, ndërtimi i argumenteve me bazë burimore dhe shprehja e qëndrimeve të mbështetura me fakte janë aftësi që zhvillohen në mënyrë të qëllimshme. Mësuesi udhëheq nxënësit të ndërtojnë narrativa historike dhe të zhvillojnë gjykim të pavarur.

Mësimi dhe ruajtja në kujtesë. Një aspekt kyç i metodologjisë së historisë është edukimi për kujtesën historike dhe ndërgjegjësimin qytetar. Përveç nxjerrjes në pah të arritjeve pozitive të shekullit XX, si përdorimi paqësor i shkencës, zhvillimi i demokracisë dhe të drejtave të njeriut, është jetike që nxënësit të ndërgjegjësohen për ngjarjet shkatërrimtare si Holokausti, gjenocidet, krimet kundër njerëzimit, spastrimet etnike dhe regjimet totalitare. Për këtë qëllim, mësimdhënia historike duhet të:

- ndihmojë nxënësit të njohin faktet dhe shkaqet e këtyre ngjarjeve;
- promovojë reflektimin mbi ideologjitë që çuan në to;
- nxisë përkujtimin përmes datave zyrtare, si 27 janari (dita e Holokaustit) dhe 23 gushti (dita përkujtimore e viktimave të totalitarizmave);
- integrojë ndihmën e Këshillit të Evropës përmes përfshirjes në iniciativat ndërkombëtare për edukimin mbi Holokaustin dhe parandalimin e urrejtjes.

Përdorimi i teknologjisë dhe burimeve digjitale. Në një botë ku të rinjtë janë të ekspozuar ndaj një fluksi të madh informacioni, teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit bëhen pjesë përbërëse e mësimdhënies së historisë. Ato:

- ofrojnë qasje të zgjeruar në burime origjinale dhe interpretime të shumëllojta;
- nxisin analizën e besueshmërisë së burimeve dhe zhvillimin e kompetencave digjitale kritike;
- ndihmojnë në bashkëpunimin dhe dialogun ndërkulturor nëpërmjet platformave ndërvepruese;
- kërkojnë nga mësuesit udhëzim të kujdesshëm për të luftuar përhapjen e përmbajtjeve raciste dhe për të respektuar lirinë e shprehjes me përgjegjësi.

Të nxënit bashkëpunues dhe ndërdisiplinor. Nxënësit punojnë në grupe për të ndërtuar projekte që ndërthurin historinë me lëndë të tjera si gjeografia, arti, qytetaria dhe teknologjia. Kjo qasje ndërdisiplinore i ndihmon të kuptojnë historinë si pjesë e një sistemi të ndërlidhur të dijeve dhe përvojave.

Përdorimi i stileve të të nxënit dhe vetëvlerësimi. Nxënësit udhëzohen të njohin stilin e tyre të të nxënit dhe të përdorin metoda që i ndihmojnë të përvetësojnë konceptet në mënyrë të qëndrueshme, duke reflektuar vazhdimisht mbi progresin dhe gabimet.

Zhvillimi i qëndrimeve pozitive dhe aftësive socio emocionale. Përmes trajtimit të temave historike që lidhen me drejtësinë, përkatësinë, bashkëjetesën dhe diversitetin, nxënësit mësojnë të kultivojnë empatinë, respektin për të tjerët, durimin, bashkëpunimin dhe vetëbesimin për të menduar në mënyrë të pavarur dhe të përgjegjshme.

Mësimdhënia e historisë në klasën e gjashtë duhet të zhvillohet si një proces i ndërgjegjshëm dhe gjithëpërfshirës, që nuk e sheh të kaluarën vetëm si dije për t'u memorizuar, por si një udhërrëfyes për ndërtimin e një të ardhmeje më të drejtë, më të vetëdijshme dhe më humane.

Të nxënit bazuar në veprimtari praktike dhe projekte dhe lidhja e historisë me jetën reale. Historia lidhet ngushtë me jetën qytetare dhe kuptimin e fenomeneve aktuale përmes analizës së ngjarjeve të së kaluarës. Të nxënit përmes veprimtarive praktike dhe projekteve i ndihmon nxënësit të kuptojnë më mirë proceset historike dhe ndikimin e tyre në shoqërinë e sotme. Këto forma të të nxënit mund të përfshijnë: hulumtime mbi tema të trashëgimisë kulturore, organizimin e ekspozitave historike në komunitet, krijimin e rrëfimeve multimediale mbi figura dhe ngjarje historike, intervista me të moshuar për të dokumentuar kujtesën historike, apo simulime të ngjarjeve të rëndësishme për të kuptuar proceset vendimmarrëse në të kaluarën. Përmes këtyre përvojave, nxënësit zhvillojnë mendimin kritik, aftësinë për të punuar në grup, dhe ndjeshmërinë qytetare.

Përfshirja dhe barazia në të nxënë. Mundësia për të përfituar nga përvojat e të nxënit në historisë duhet t'u ofrohet të gjithë nxënësve, pa përjashtim. Mësimdhënia duhet të bazohet në interesin më të lartë të fëmijës, duke garantuar trajtimin e barabartë me dinjitet dhe respekt për të gjitha dallimet, qofshin ato kulturore, sociale apo individuale.

Gjatë orëve të ndryshme të mësimi, metodat e teknikat ndërthuren me njëra-tjetrën, aq sa shpesh nuk mund t'i dallosh kufijtë midis tyre, prandaj, vëmendja e veçantë e mësuesit duhet drejtuar te lidhja organike e metodave dhe e teknikave të veçanta që ai përdor brenda një ore mësimi. Në ndihmë të zbatimit të këtyre metodologjive, në program parashtrihen një sërë veprimtarish të sugjeruara, të cilat i ndihmojnë nxënësit në zotërimin e kompetencave dhe në arritjen e rezultateve të të nxënit të parashikuara në program.

Mësuesi duhet të tregojnë kujdes të veçantë që nxënësit të nxiten vazhdimisht të reflektojnë në mënyrë kritike mbi ecurinë e të nxënit dhe punës së tyre në shkollë dhe të transferojnë ata ç'ka kanë mësuar në situata jetësore brenda dhe jashtë shkollës.

Mundësia për të marrë pjesë dhe për të përfituar nga përvojat e lëndës së historisë ashtu si nga çdo lëndë tjetër në shkollë, duhet t'u ofrohet të gjithë nxënësve pa përjashtuar askënd për asnjë shkak. Mësimdhënia duhet të bazohet në interesin më të lartë të nxënësit dhe duhet të sigurojë trajtimin e barabartë me dinjitet e respekt të gjithsecilit.

5.1 Roli i situatave të të nxënit nga jeta reale në mësimin e historisë

Një ndër mënyrat më kuptimplota për të nxitur interesin dhe për të ndërtuar një të kuptuar të thelluar historik në arsimin e mesëm të ulët është përfshirja e situatave reale dhe praktike nga jeta e përditshme në procesin e të nxënit. Kur nxënësit lidhen me histori përmes konteksteve që reflektojnë sfida aktuale shoqërore, zhvillime komunitare apo përvoja familjare, ata e kuptojnë se historia nuk është vetëm një rrëfim i së kaluarës, por një mjet i fuqishëm për të interpretuar të tashmen dhe për të ndërtuar të ardhmen.

Situatat praktike mund të përfshijnë, për shembull: studimin e ngjarjeve lokale përmes intervistimit të të moshuarve; analizimin e burimeve dokumentare për të kuptuar sesi janë marrë vendime të rëndësishme politike; krahasimin e migrameve historike me ato moderne për të kuptuar ndikimet kulturore dhe sociale; apo projektimin e një ekspozite për trashëgiminë kulturore në bashkëpunim me muzeun lokal. Këto përvoja e bëjnë mësimin më angazhues dhe të prekshëm, duke i ndihmuar nxënësit:

- të kuptojnë vlerën funksionale të dijes historike në jetën qytetare, si mjet për të gjykuar me përgjegjësi, për të ndërtuar qëndrime demokratike dhe për të reflektuar mbi drejtësinë dhe liritë themelore;
- të zhvillojnë mendimin kritik, empatinë historike dhe aftësinë për të analizuar situata nga perspektiva të ndryshme kohore dhe kulturore;
- të ndërtojnë kompetenca të kërkimit dhe interpretimit të fakteve, duke u bërë qytetarë aktivë që ndërveprojnë në mënyrë të vetëdijshme me historinë dhe pasojat e saj në shoqërinë moderne.

5.1.1 Shembull i një situate të nxëni në klasën e gjashtë

Tema e orës: Trashëgimia kulturore në qytetërimet e lashta

Situata e të nxënit:

Mësuesi nis orën duke shfaqur në ekran ose duke treguar një imazh të fundit nga një lajm në internet që pasqyron dëmtimin ose restaurimin e një monumenti antik në Shqipëri (p.sh., Amfiteatri i Durrësit ose qyteti antik i Apolonisë). Ai i drejtohet klasës me pyetjet: ***A keni vizituar ndonjë monument të lashtë si këto? Pse mendoni se këto vende janë kaq të rëndësishme për ne sot?***

Pas disa komenteve nga nxënësit, mësuesi shton: ***Sot do të flasim për trashëgiminë kulturore të qytetërimeve të lashta dhe mënyrën si ajo ka mbijetuar deri në ditët tona. Ato nuk janë thjesht rrënoja, por dëshmi të historisë dhe të identitetit tonë.***

Qasje metodologjike: Përdorimi i situatave reale, diskutim i udhëzuar, konkretizim përmes imazheve.

Nxënësit aftësohen të:

- Zhvillojnë kompetenca historike, përmes përdorimit të burimeve historike dhe analizës së lidhjes ndërmjet së kaluarës dhe të tashmes;
- Vlerësojnë rëndësinë e trashëgimisë kulturore si pjesë e historisë dhe identitetit të tyre;
- Dallojnë ndikimin e qytetërimeve të lashta në jetën bashkëkohore;
- Zhvillojnë ndjenjën e vlerësimit dhe përgjegjësisë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore;
- Forcojnë ndjenjën e përkatësisë dhe të identitetit kombëtar.

Në këtë mënyrë, historia nuk mbetet një lëndë që mësohet përmes datash dhe emrash, por shndërrohet në një udhëtim të gjallë kërkimi dhe reflektimi, që i ndihmon nxënësit të kuptojnë më thellë identitetin, shoqërinë dhe rolin e tyre në të. Ajo bëhet një urë lidhëse mes të shkuarës, të tashmes dhe të ardhmes, duke fuqizuar formimin qytetar dhe përgatitjen për një jetë sociale të ndërgjegjshme e të informuar.

5.2 Roli i veprimtarive praktike dhe projekteve kurrikulare në lëndën e historisë

Në përmbajtjen e programit të historisë për arsimin e mesëm të ulët një vend të veçantë zë zhvillimi i veprimtarive praktike, të cilat zënë një pjesë thelbësore të procesit të të nxënës. Këto veprimtari janë të sugjeruara. Përmes veprimtarive praktike të sugjeruara, mësuesi dhe hartuesi i tekstit kanë mundësi të lidhin historinë me fusha të tjera të të nxënës dhe me temat ndërkurrikulare, duke krijuar një përvojë të pasur dhe të integruar për nxënësit. Këto veprimtari shërbejnë si një mjet i fuqishëm për të ndihmuar nxënësit të përvetësojnë më mirë përmbajtjen historike, duke e bërë atë më konkrete, më të kuptueshme dhe më të lidhur me jetën e tyre të përditshme. Në këtë proces, nxënësit mësojnë jo vetëm “çfarë ka ndodhur”, por edhe si të mësojnë për historinë, duke përdorur burime të ndryshme, duke analizuar, diskutuar dhe ndërtuar mendime personale mbi ngjarjet dhe figurat historike.

Gjithashtu, veprimtaritë luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kompetencave historike, aftësive të mendimit kritik dhe zgjidhjes së problemeve, si dhe në ndërtimin e identitetit kombëtar, forcimin e ndjenjës së patriotizmit, vlerësimin e trashëgimisë kulturore dhe kuptimin e ndikimeve ndërkulturore. Ato krijojnë hapësira për të trajtuar tema që lidhen me rreziqet natyrore, pandemitë, krizat ekonomike dhe politike, si dhe për të kuptuar rolin e historisë në përballimin e sfidave bashkëkohore. Po ashtu, ndihmojnë nxënësit të reflektojnë mbi ndikimin e zhvillimeve teknologjike në transformimin e jetës shoqërore dhe të realitetit aktual.

Veprimtaritë praktike dhe projektet kurrikulare përbëjnë jo vetëm një mjet për të përvetësuar më mirë përmbajtjen mësimore, por edhe një hapësirë për të ndërtuar mendim kritik dhe ndjeshmëri qytetare. Përmes këtyre veprimtarive, nxënësit mësojnë jo vetëm “çfarë ka ndodhur”, por edhe “si të mësojnë për historinë”, duke përdorur burime të ndryshme, duke analizuar, diskutuar dhe ndërtuar përfundime të argumentuara.

Projektet kurrikulare mund të përfshijnë:

- krijimin e një ekspozite mbi historinë lokale apo trashëgiminë kulturore të komunitetit;
- hulumtime mbi ngjarje të rëndësishme për historinë kombëtare dhe krahasimin e tyre me zhvillime të ngjashme ndërkombëtare;
- ndërtimin e linjës së kohës dhe interpretimi i hartave historike që tregojnë ndryshime gjeopolitike në kohë;
- intervista me të moshuar për të dokumentuar kujtesën historike;
- produktet digjitale si prezantime, video dokumentarë, ose rrëfime vizuale që ilustrojnë figura apo ngjarje të caktuara historike.

Këto veprimtari kontribuojnë në:

- zhvillimin e kompetencave historike dhe qytetare;
- ushtrimin e mendimit kritik dhe zgjidhjes së problemeve në kontekste historike;
- ndërtimin e identitetit kombëtar dhe kuptimin e ndikimeve ndërkulturore;
- reflektimin mbi sfidat bashkëkohore si krizat ekonomike, pandemitë, teknologjia dhe ndryshimet sociale përmes lenteve të së kaluarës.

Roli i mësuesit në këtë proces është udhëheqës dhe mbështetës: ai ndihmon nxënësit të formulojnë pyetje historike, të planifikojnë projektin, të analizojnë burime të besueshme dhe të prezantojnë në mënyrë të qartë përfundimet e tyre.

Mësuesi gjithashtu udhëzon integrimin e përmbajtjeve të historisë me fusha të tjera të të nxënësve, si gjeografia, letërsia, arti, teknologjia dhe edukimi qytetar, duke krijuar një përvojë të pasur dhe të integruar mësimore.

Në këtë mënyrë, veprimtaritë praktike dhe projektet kurrikulare e shndërrojnë historinë në një lëndë që lidhet drejtpërdrejt me jetën reale, që nxit reflektim mbi të kaluarën dhe i përgatit nxënësit për të qenë qytetarë të vetëdijshëm dhe të përfshirë në të tashmen dhe në të ardhmen.

5.3 Puna me nxënësit me nevojë të veçanta në lëndën e historisë

Nxënësit me nevojë të veçanta

Organizimi i kurrikulës sipas kompetencave, në fusha të nxënësve, në shkallë, dhe me fokus integrimin u krijon mësuesve hapësirat për të përshtatur mësimdhënien sipas nevojave të veçanta të nxënësve dhe për të personalizuar të nxënësve të tyre. Mësuesit duhet të marrin parasysh faktin se nxënësit janë të ndryshëm, kanë motivim, interesa, stile të nxënësve, nevojë dhe aftësi të ndryshme etj. Në disa raste duhen bërë përshtatje të kurrikulës sipas diferencave të zhvillimit brenda një grupi moshor. Mësuesit mund të zgjerojnë zhvillimin e kompetencave kyçe si ato të komunikimit, të menduarit dhe shoqërore sipas nevojave individuale të nxënësve, për të zvogëluar dhe zhdukur diferencat brenda një shkalle të kurrikulës, në fund të saj.

Nxënësit me vështirësi në të nxënë

Shumë nxënës me vështirësi arrijnë rezultatet e pritshme të të nxënësve njësoj si nxënësit e tjerë, nëse bëhen përshtatje në mënyrën e mësimdhënies dhe të vlerësimit të tyre.

Për të arritur nivelin më të lartë të mundshëm të realizimit të kompetencës, mund të zhvillohen programe të veçanta, individuale, për nxënësit me nevojë të veçanta. Në rastin e nxënësve që formalisht janë përcaktuar si të veçantë, është veçanërisht e rëndësishme që stafi i shkollës, në bashkëpunim me prindërit, të mbështesë të nxënësve të tyre. Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënës me nevojë të veçanta duhet të diskutohen herë pas here me prindërit dhe vetë nxënësit. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve.

Nxënësit e talentuar

Fleksibiliteti i zhvillimit të programit lejon plotësimin e nevojave individuale të nxënësve të talentuar. Mësuesit duhet t'u krijojnë kushte dhe situata të tilla që nxënësit të shfaqin dhe të zhvillojnë talentet e tyre. Kjo arrihet nëse atyre u krijohen mundësitë të punojnë me një përmbajtje më të thelluar dhe zgjeruar, të zhvillojnë në mënyrë të vazhdueshme elemente specifike të kompetencave kyçe (p.sh.: aftësitë e nivelit të lartë konjitiv të kompetencës të të menduarit) dhe specifike të fushës, të fokusohen në çështjet kros-kurrikulare, të zgjerojnë mjediset dhe materialet e të nxënit brenda dhe jashtë shkollës.

6 VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi është një aspekt i rëndësishëm i lëndës së historisë. Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënit bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies, i cili përqendrohet në nivelin e arritjes së kompetencave, fokusohet në matjen e njohurive e aftësive, në arritjen e rezultateve të të nxënit, dhe në nivelin e përbushjes së kompetencave. Informacioni i siguruar nga vlerësimi, e ndihmon mësuesin të evidentojë përparimin e nxënësve, të vlerësojë se sa të përshtatshme e të dobishme janë metodat e mësimdhënies që ai përdor, të përmirësojë mësimdhënien dhe të pajisë nxënësit me informacionin përkatës për progresin e tyre.

Vlerësimi është një informacion i rëndësishëm që i shërben nxënësve për të ndjekur vetë ecurinë e tyre në këtë lëndë, për të njohur anët e tyre të forta dhe vështirësitë që hasin në zotërimin e njohurive dhe kompetencave, në mënyrë që të punojnë përkatësisht për përforcimin dhe kapërcimin e tyre. Vlerësimi është një informacion i rëndësishëm edhe për prindërit, me anë të të cilit ata mund të ndihmojnë më mirë në edukimin e fëmijëve të tyre.

I domosdoshëm është vlerësimi i përmbajtjes të lëndës lidhur me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive historike nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e tyre. (p.sh. vetëvlerësimi, intervistë me një listë treguesish, testi objektiv, vëzhgimi i kërkimit historik me një listë të saktë treguesish, portofoli, prezantimi me gojë ose me shkrim, projekti kurrikular etj.).

Në përzgjedhjen e praktikave të vlerësimit, në përcaktimin e kohës së përshtatshme, në përzgjedhjen e materialeve për vlerësim mësuesi duhet të ketë parasysh:

- Përcaktimin e qëllimit dhe strategjisë së vlerësimit;
- përzgjedhjen e veprimtarive, që mundësojnë demonstrimin e arritjes së kompetencave
- përdorimin e vlerësimit për të verifikuar çfarë dinë aktualisht nxënësit;
- dallimin qartë të qëllimit të detyrës së zgjedhur për vlerësim.

Vlerësimi i nxënësve duhet të nxjerrë në pah arritjet e tyre, në mënyrë që ata të inkurajohen të mësojnë me më shumë dëshirë. Ai duhet të konsiderohet si një mjet në ndihmë të nxënësve, i cili i ndihmon ata të njohin më mirë aftësitë e tyre në të nxënë, të zhvillojnë e të përdorin talentet dhe aftësitë në mënyra sa më të dobishme. Nxënësit vetë duhet të jenë pjesë e procesit të vlerësimit të arritjeve të tyre.

Me anë të vlerësimit, mësuesi informohet rreth çfarë dhe si po mësojnë nxënësit, ç'ka e ndihmon atë të planifikojë mësimdhënien në vijim dhe të përgatisë materiale ose të rishikojë metodologjinë e mësimdhënies për t'iu përshtatur nevojave të nxënësve. Vlerësimi nga ana e mësuesit duhet të marrë në konsideratë edhe aftësinë e nxënësve për të përcaktuar e arritur objektiva për veten.

a) Vëzhgimi

Mësuesi vlerëson ecurinë e nxënësve duke i vëzhguar ata gjatë punës individuale ose në grup, si dhe ndërveprimin e tyre gjatë veprimtarive të ndryshme në klasë dhe në shkollë. *Mësuesi vëzhgon aspekte, të tilla si:*

- Aftësinë e nxënësve për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të bashkëpunuar në grup;
- ndërveprimet e nxënësve me njëri-tjetrin dhe me të rriturit;
- cilësinë e prezantimit të punimeve;
- interesat, aftësitë ose talentet e veçanta të nxënësve;
- pjesëmarrjen dhe interesin që shprehin nxënësit në veprimtari e aktivitete të ndryshme;
- përgjegjësinë vetjake dhe shoqërore që shfaqin nxënësit;
- përkushtimin dhe këmbënguljen e nxënësve në kryerjen e detyrave të ndryshme;
- nivelin e ndërgjegjësimit të nxënësve për vështirësitë që mund të kenë të tjerët dhe gatishmërinë për t'i ndihmuar ata;

- pyetjet që shtrojnë nxënësit, përgjigjet dhe sugjerimet që nxënësit u japin pyetjeve të mësuesit dhe nxënësve të tjerë;
- sjellje të caktuara, si: aftësitë drejtuese, niveli i vetëbesimit, të shprehurit në mënyrë të drejtpërdrejtë e të hapur, gatishmëria për të përballuar rreziqe, sfida e vështirësi;
- pjekurinë fizike dhe emocionale;
- aftësinë për të vetë-vlerësuar ecurinë në shkollë.

Mësuesi i vëzhgon nxënësit jo vetëm në klasë, por edhe jashtë saj, në aktivitete të ndryshme shkollore, për shembull gjatë lojës, në festime, në ekskursionet etj. Mësuesi mund t'i mbajë shënim vëzhgimet për secilin nxënë, në mënyrë që të mund të krijojë një pamje të përgjithshme të ecurisë së zhvillimit të tyre. Kjo i shërben mësuesit edhe për t'ia komunikuar ecurinë e nxënësve prindërve të tyre, ose në raste kur nxënësi ndryshon shkollë, ky lloj vlerësimi mund të ndahet me mësuesin e ri ose me mësuesit pasues të ciklit në vijim.

Vëzhgimi ndihmon sidomos vetë mësuesin, i cili, pasi ka kuptuar nevojat e veçanta të secilit nxënë, duhet të rishikojë metodologjitë e mësimdhënies, në mënyrë që ato të lehtësojnë të nxënit e gjithsecilit. Nëse mësuesi vë re nevoja të veçanta në sjelljen e nxënësve, karakteristike për nxënësit në shkollën e tij, në bashkëpunim me mësuesit e tjerë dhe drejtuesin e shkollës, mund të vendosë të fokusohet më gjatë në atë aspekt të programit, i cili ndihmon në përmbushjen e këtyre nevojave.

b) Detyrat dhe testet

Me anë të detyrave të ndryshme që mësuesi u jep nxënësve në klasë, ai arrin të vlerësojë si procesin e punës, ashtu edhe nivelin e të kuptuarit të njohurive të reja nga ana e nxënësve. Me anë të detyrave, mësuesi mund të vlerësojë edhe aftësinë e nxënësve për t'i përdorur dijet e marra në situata nga më të ndryshmet. Detyrat në klasë mund të jenë projekte në grup ose punë individuale.

Një shembull i detyrës në klasë mund të jetë dhënia e një situatë, e cila kërkon zgjidhje, ku nxënësit duhet të marrin një vendim së bashku dhe ta mbrojnë atë. Gjatë punës në grup të nxënësve, mësuesi vlerëson demonstrimin e kompetencave dhe aftësinë e gjithsecilit për të punuar në grup.

Testet, si teknika vlerësimi, rekomandohet të përdoren duke filluar nga klasa e gjashtë e më tej, pasi nxënësit të jenë zhduerjellësuar në të shkruar dhe të kenë nisur të marrin njohuri të mirëfillta, të cilat mund të testohen me shkrim. Mësuesi mund t'i përdorë testet me shkrim në fund të një

tematike si një teknikë vetëvlerësimi nga ana e nxënësve, pra t'i lejojë ata t'i korrigjojnë vetë testet për të reflektuar e për t'u ndërgjegjësuar mbi aftësitë dhe kufizimet e tyre.

c) Projektet

Projektet i ndihmojnë nxënësit të përqendrohen në një temë të caktuar të programit, për shembull në njohjen e komunitetit ku ata jetojnë dhe studimin e tij në detaje. Me anë të projektit, mësuesi vlerëson aftësinë e nxënësve për të mbledhur informacion, për ta përpunuar dhe për ta prezantuar atë. Puna me projekte mundëson edhe vlerësimin e bashkëpunimit të nxënësve me njëri-tjetrin gjatë punës grup. Realizimi i një projekti është tregues edhe i përgjegjësisë vetjake dhe të grupit, si dhe i përkushtimit dhe interesit të secilit nxënës.

d) Paraqitja dhe prezantimi i punimeve

Shpjegimi, paraqitja dhe prezantimi i punimeve të ndryshme që nxënësit realizojnë gjatë lëndës së historisë është për mësuesin tregues i aftësive të tyre për të mbledhur informacion, për ta përpunuar dhe për ta paraqitur atë. Gjatë paraqitjes dhe prezantimit të punimeve, nxënësit vlerësohen edhe për shtjellimin e këndvështrimeve të tyre, mbrojtjen e këtyre këndvështrimeve dhe mbajtjen e qëndrimit vetjak ose në grup ndaj një çështjeje të caktuar. Me anë të kësaj teknike vlerësohen kompetencat historike dhe kompetencat kyçe si ajo e komunikimit dhe e të menduarit.

Pavarësisht zgjedhjes nga ana e mësuesit të teknikave të vlerësimit, qofshin këto formale ose joformale, vlerësimi duhet domosdoshmërisht të synojë përmirësimin e përvojave të nxënësit të nxënësve. Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Objektivi i vlerësimit, nuk janë vetëm kompetencat, njohuritë dhe shprehjet, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etike-sociale, në përgjithësi, edhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti.

Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj. Vlerësimi mbështetet tërësisht në njohuritë e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato njohuri që nuk përshkruhen në program.

6.1 Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit, RN-ve.

Në këtë rubrikë paraqiten disa shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit në tematika të ndryshme.

Tabela 4. Shembull për nivelet e arritjes për vlerësimin e RN-ve

Shembull 1.			
Rezultati i të nxënit (RN): Nxënësi kërkon, grumbullon, përzgjedh materiale, duke evidentuar lidhjen e shqiptarëve me qytetërimet evropiane të shek. XV			
Niveli i arritjes: Shumë mirë	Niveli i arritjes: Mirë	Niveli i arritjes: Mjaftueshëm	Niveli i arritjes: Dobët
Nxënësi gjen vetë materiale historike të përshtatshme, i zgjedh ato me kujdes dhe i përdor për të treguar qartë se si shqiptarët kanë bashkëpunuar apo kanë pasur lidhje me vende të tjera të Evropës në shekullin XV. Jep shembuj të saktë dhe i shpjegon me fjalët e veta.	Nxënësi arrin të gjejë dhe të zgjedhë disa materiale që lidhen me temën. I përdor ato për të treguar disa mënyra se si shqiptarët kanë pasur lidhje me Evropën. Mund të mos japë shumë detaje, por kuptimi i përgjithshëm është i saktë.	Nxënësi përpiqet të gjejë informacion, por ka vështirësi të zgjedhë materialet e duhura. Jep shembuj të pjesshëm ose jo gjithmonë të saktë. Ka nevojë për ndihmën e mësuesit për të kuptuar dhe shpjeguar lidhjen me Evropën.	Nxënësi nuk arrin të gjejë ose të zgjedhë materiale që lidhen me temën. Nuk tregon se e kupton se si shqiptarët kanë qenë të lidhur me qytetërimet evropiane. Ka shumë pasaktësi dhe nuk jep shembuj të qartë, edhe me ndihmën e mësuesit.

Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e historisë do të përshkruhen nivelet e arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit sipas tematikave të lëndës.

7 BURIMET DHE MATERIALET DIDAKTIKE

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe në procesin e të nxënit në lëndën e historisë, ndihmon në konkretizimin e ideve dhe të dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më rezultativ për nxënësit. Përdorimi

i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura, nuk mund të realizohet pa ***mjetet e nevojshme didaktike***, të cilat janë të llojeve të ndryshme, si: *harta historike të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta, kompjuter, aparat projekcioni, CD, DVD, TIK, etj.* Këto mjete po zënë gjithnjë e më shumë vendin që u takon për konkretizimin e një sërë ngjarjesh historike, të cilat janë vështirë të kuptohen pa një konkretizim audioviziv etj.

Mësuesi i historisë mund të integrojë një gamë të gjerë materialesh për të bërë mësimin sa më të qartë dhe të aksesueshëm për të gjithë nxënësit, si:

- ***Materiale vizuale dhe grafike:*** fotografi historike, harta, linja kohore, piktura murale, dokumente të vjetra, skema konceptuale;
- ***Objekte reale dhe kopje burimesh historike:*** letra, ditarë, monedha, objekte muzeale ose modele të tyre në klasë;
- ***Mjete teknologjike:*** projektorë, kompjuterë, tableta, platforma digjitale (si Wikipedia Edu, Historiana, Time Maps, Google Arts & Culture), aplikacione për eksplorimin e burimeve multimediale dhe për ndërtimin e ekspozitave virtuale.

Gjatë shpjegimit të temave, mësuesi përdor gjuhë të qartë, fjali të thjeshta dhe një fjalor të përshtatur për moshën dhe nivelin e nxënësve. Ai/ajo zgjedh shembuj konkretë dhe pyetje të hapura që nxisin diskutim dhe reflektim. Përveç tekstit shkollor, përdorimi i fletoreve të punës, burimeve të shtypura dhe digjitale, dokumentarëve edukativë dhe platformave të mësimin ndihmon në pasurimin e përvojës mësimore të nxënësve.

7.1 Përdorimi i teknologjisë si mjet dhe teknikë mësimore në lëndën e historisë

Në arsimin e mesëm të ulët, teknologjia luan një rol të rëndësishëm në përafrimin e nxënësve me përmbajtjen historike përmes mënyrave të reja të të mësuarit. Qasjet ndërdisiplinore dhe përdorimi i teknologjisë në histori ndihmojnë nxënësit të ndërtojnë mendim historik, të analizojnë burime, të ndërtojnë narracione dhe të zhvillojnë ndjeshmëri qytetare. Disa mënyra konkrete se si mund të përdoret teknologjia në mësimin e historisë janë:

- ***Krijimi i linjave kohore digjitale.*** Nxënësit përdorin platforma si Canva për të ndërtuar kronologji vizuale të periudhave historike.
- ***Analiza e burimeve historike përmes mjeteve multimediale.*** Përdorimi i videove dokumentare, regjistrimeve audio, faksimileve të dokumenteve për të analizuar dëshmi të së kaluarës.

- **Eksplorimi i vendeve historike përmes hartave digjitale dhe realitetit virtual.** Aplikacione si Google Earth apo turizmi virtual në muze ndihmojnë nxënësit të “vizitojnë” vende me rëndësi historike.
- **Ndërtimi i projekteve digjitale.** Nxënësit krijojnë prezantime, postera virtuale, ose rrëfime historike digjitale që përfshijnë hulumtim, interpretim dhe krijimtari.
- **Simulime historike dhe role-playing online.** Përdorimi i simulimeve ku nxënësit marrin rolin e personazheve historikë për të debatuar vendime të së kaluarës.
- **Përdorimi i platformave interaktive.** Aplikacione si Kahoot, Quizlet apo Wordwall përdoren për rikujtim, testim njohurish apo ndarjen e ideve rreth një teme historike.

Përveç aspekteve didaktike, teknologjia ofron edhe një mundësi për të zhvilluar **kompetenca digjitale**, për të nxitur **punën bashkëpunuese**, për të **personalizuar të nxënit** dhe për të **stimuluar mendimin kritik dhe kreativitetin** në raport me përmbajtjen historike. Në këtë mënyrë, përdorimi i teknologjisë dhe materialeve të larmishme në mësimin e historisë nuk është vetëm një zgjedhje metodike, por një domosdoshmëri për ta bërë këtë lëndë funksionale, tërheqëse dhe të lidhur ngushtë me jetën reale dhe sfidat e qytetarisë së sotme.

8 REKOMANDIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Hartimi i programit lëndor të historisë rrjedh nga Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, Kurrikulat Bërthamë, Planit Mësimor i Arsimit azë dhe Rekomandimet Rek (2001)¹⁵ të Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare lidhur me mësimin e historisë në Evropë në shekullin XXI. Programi i historisë trajton ngjarjet historike në një kornizë kronologjike e tematike. Vazhdimësia kronologjike mundëson lidhjen e brendshme e të jashtme midis ngjarjeve, periudhave dhe shoqërive të ndryshme, si dhe lidhjet e qytetërimit të popullit shqiptar me qytetërimet botërore. Programi synon që të krijojë te nxënësit bindjen se qytetërimet e sotme janë një vazhdimësi progresive e qytetërimeve të hershme, pra e sotmja e ka burimin tek e kaluara dhe është e lidhur me të. Ky këndvështrim i ndihmon nxënësit të ndërtojnë perspektivat e një ngjarjeje apo procesi historik ose të parashikojnë trendin e përgjithshëm të këtyre proceseve.

Ruajtja e kronologjisë zbaton kriterin shkencor të zhvillimit të ngjarjeve mbi lidhjen shkak-pasojë dhe vazhdimësinë progresive të rrjedhës historike. Trajtesa tematike shpreh natyrën përzgjedhëse të programit, i cili nuk ka si qëllim të mbulojë të gjitha ngjarjet e historisë, gjë që do të sillte një ngarkesë të panevojshme për nxënësit, por të trajtojë problemet thelbësore, modelet historike që përbëjnë rrënjët e qytetërimeve të sotme. Trajtesa tematike ka pasur parasysh edhe vendosjen e një baraspeshe historike mes kontributeve të krijuara në periudha të ndryshme në lindjen dhe zhvillimin e qytetërimeve pasardhëse, duke shprehur vlerat e tyre në një këndvështrim të barabartë.

Sqarim për veprimtaritë praktike të sugjeruara dhe orët mësimore të dedikuara për zhvillimin e tyre

- Për çdo tematikë të përfshirë në program, është sugjeruar një numër i caktuar orësh mësimore që përfshin si kohën e nevojshme për zhvillimin e njohurive të reja ashtu edhe kohën e parashikuar për realizimin e veprimtarive praktike të paraqitura në rubrikën “Veprimtari të sugjeruara për tematikën”. Këto dy komponentë të integruara së bashku synojnë të nxisin zhvillimin e njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave të nxënësit.
- Rekomandohet që rreth 30% e orëve mësimore të parashikuara për zhvillimin e një tematike t’i dedikohet veprimtarive praktike, ndërsa 70% të fokusohet në zhvillimin e përmbajtjes mësimore dhe ndërtimin e njohurive. Kjo ndarje është orientuese dhe jo detyruese, duke u lënë mësuesve hapësirë për përshtatje, në përputhje me nevojat e nxënësve dhe kontekstin konkret të mësimdhënies.
- Veprimtaritë praktike janë të sugjeruara, që do të thotë se mësuesit dhe hartuesit e teksteve kanë lirinë t’i përshtatin ose t’i zëvendësojnë ato, në varësi të nevojave të nxënësve, qëllimeve për zhvillimin e kompetencave, si dhe në përputhje me zhvillimet aktuale shoqërore që mund të ndikojnë në procesin mësimor dhe edukativ.
- Mësuesi mund t’i zhvillojë veprimtaritë gjatë gjithë trajtimit të tematikës dhe jo vetëm në përfundim të saj. Kjo qasje ndihmon në aktualizimin e njohurive dhe lehtëson procesin e të nxënësve, duke e bërë atë më të kuptueshëm dhe më të lidhur me përvojën e përditshme të nxënësit.
- Ju kujtojmë se gjatë zhvillimit të temave të historisë së qytetërimeve botërore, është e rëndësishme të realizohen paralelizma me historinë e Shqipërisë dhe anasjelltas, sipas periudhave përkatëse. Për këtë arsye, ju inkurajojmë të përzgjidhni ato veprimtari që lidhen me zhvillimet historike në Shqipëri ose në botë, të cilat përkojnë me tematiken dhe periudhën që trajtohet në program.

- Në rubrikën “Veprimtari të sugjeruara për arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-të; 7-të; 8-të dhe 9-të), për secilën tematikë të programit përkatës, janë propozuar më shumë se një veprimtari praktike, me qëllim që mësuesi të ketë një gamë të larmishme zgjedhjesh. Mësuesi, në varësi të numrit të orëve që ka në dispozicion, zgjedh veprimtarinë ose veprimtaritë që i konsideron më të përshtatshme për përmbushjen e rezultateve të të nxëniet dhe për zhvillimin e kompetencave të nxënësve.
- Në rast se mësuesi vëren se tema e një veprimtarie është e gjerë dhe kërkon më shumë se një orë për t’u zhvilluar me nxënësit në klasë, ai përzgjedh vetëm një veprimtari nga lista e ofruar për tematiken përkatëse dhe ta shtrijë atë në kohë, sipas nevojës.

a) Rekomandime për mësuesit

- Të lidhin përmbajtjen e historisë me fusha të tjera (shkencë, teknologji, inxhinieri, art, gjuhë, edukatë qytetare, etj.) për të ndihmuar kuptimin e thelluar dhe zbatimin praktik të koncepteve dhe për të kuptuar profesione të ndryshme.
- Të planifikojnë mësimin duke respektuar ritmet dhe nevojat individuale të nxënësve me nevoja të veçanta dhe për fëmijët me aftësi me talente.
- Të nxisin mjedisin bashkëpunues, të sigurt, ku nxënësit ndihen të vlerësuar dhe të mbështetur në zhvillimin socio emocional.
- Të sigurojnë akses të barabartë në mësim për të gjithë nxënësit, përfshirë ata nga pakicat kombëtare dhe grupe të marginalizuara.
- *Të sigurojnë balancën mes përmbajtjes teorike dhe zhvillimit të veprimtarive praktike të historisë (p.sh. sugjerohet 70% teori — 30% praktikë). Mësuesi është fleksibël që në varësi të kontekstit të ndryshojë këto përqindje.*
- Të përfshijnë platforma digjitale interkative për mësimin e historisë.
- Të sigurojnë dhe të përdorin librat origjinal të mësuesit si pjesë e paketës së teksteve shkollore.
- Të sigurojnë dhe të përdorin udhëzuesit kurrikularë të lëndës së historisë.
- Të përdorin materialet burimore për zbatimin e programit.

b) Rekomandime për autorët e teksteve shkollore

- Të përshtatin në mënyrë cilësore tekstet shkollore duke reflektuar të gjitha përditësimet më të fundit.
- Të përfshijnë platforma digjitale interkative për mësimin e historisë, në tekstet shkollore.

- Të përfshijnë burime të ndryshme për mësimin praktik të historisë.
- Të citojnë burimet e përdorura si pjesë e tekstit shkollor.
- Të sigurojnë materialet burimore edhe digjitale për zbatimin e tekstit shkollor.
- Të lidhin konceptet historike me fusha të tjera dhe me situata të jetës reale, në tekstet shkollore.
- Të përfshijnë në tekstet shkollore veprimtari dhe detyra që promovojnë mendimin kritik, zgjidhjen e problemeve dhe krijimtarinë.
- Të krijojnë hapësirë në tekstet shkollore për shembuj dhe ushtrime që nxisin orientimin për karrierë, përmes profesioneve ku historia luan rol.
- Të sigurojnë që tekstet të kenë qasje gjithëpërfshirëse dhe të përshtatshme për moshën, duke marrë parasysh diversitetin kulturor dhe aftësitë e ndryshme të nxënësve.

c) Rekomandime për hartuesit e testeve kombëtare

- Të sigurojnë që testet të përmbajnë jo vetëm pyetje që matin njohuritë, por edhe pyetje me situata që integrojnë qasje ndërdisiplinore, që nxisin të menduarit logjik, të menduarin kritik dhe krijues, jo thjesht memorizimin.
- Të përfshijnë pyetje që lidhin konceptet historike me koncepte të lëndëve apo fushave të tjera.
- Të kenë parasysh nivelin e diversitetit të nxënësve, duke përfshirë pyetje që janë të qarta dhe të kuptueshme për të gjithë, pavarësisht sfondit kulturor ose gjuhësor.
- Të hartojnë modele të testeve kombëtare në mënyrë që të punohen nga nxënësit gjatë viteve të shkollimit.

d) Rekomandime për vlerësuesit e jashtëm

- Të vlerësojnë mësuesit për cilësinë e mësimdhënies në zbatim të programit dhe rubrikave të këtij programi.
- Të vlerësojnë mësuesit për përdorimin e situatave nga jeta reale në përvetësimin e koncepteve historike.
- Të vlerësojnë përfshirjen e situatave nga jeta reale dhe çështjeve aktuale shoqërore për zhvillimin e mësimi të historisë dhe të projekteve kurrikulare.
- Të vlerësojnë përdorimin e niveleve të arritjes për përmbushjen e rezultateve të të nxënësit.

- Të vlerësojnë organizimin e punës në grupe dhe bashkëpunimin në veprimtaritë mësimore.
- Të vlerësojnë balancën mes përmbajtjes teorike dhe zhvillimit të veprimtarive praktike gjatë zhvillimit të orëve mësimore të historisë.
- Të nxisin mësuesit që të krijojnë mjedise të përshtatshme për personalizimin e të nxënësve dhe për mbështetjen e diversitetit në klasë.
- Të vlerësojnë se si mësuesit promovojnë mirëqenien socio-emocionale të nxënësve përmes mënyrës së komunikimit dhe aktiviteteve në orën e historisë.
- Të vlerësojnë që mësuesit garantojnë qasje të barabartë në mësim për të gjithë nxënësit, përfshirë pakicat kombëtare dhe grupet vulnerabël.

e) Rekomandime për prindërit

- Të inkurajojnë fëmijët që të kuptojnë rëndësinë e historisë jo vetëm për notë, por për jetën e përditshme.
- Të bashkëpunojnë me shkollën për të ndihmuar fëmijët në pjesëmarrjen në projekte dhe konkurse që lidhen me historinë.
- Të promovojnë një qëndrim pozitiv ndaj mësimi të historisë, duke theksuar rëndësinë e saj për të kuptuar zhvillimet shoqërore dhe për të mësuar nga gabimet e të shkuarës.
- Të sigurojnë që fëmijët ndihen të mbështetur emocionalisht dhe që mësimi i historisë zhvillohet në një mjedis të qetë, të barabartë dhe motivuese për fëmijët e tyre.
- Të kuptojnë rëndësinë e historisë si bazë për profesione të ndryshme dhe të eksplorojnë interesat personale në këtë drejtim.

9 NDRYSHIMET E PROGRAMIT TË HISTORISË, KLASA VI

Programi i historisë është përditësuar me qëllim që të jetë më gjithëpërfshirës dhe të përgjigjet më mirë ndaj nevojave të një shoqërie demokratike dhe të ndërlidhur globalisht. Ky përditësim thekson rëndësinë që historia t'i kushtojë zhvillimeve të reja shoqërore, ndryshimeve klimatike dhe mjedisore, zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe bashkëjetesës paqësore në një botë gjithnjë e më komplekse. Ndryshimet kryesore të ndërmarra në program synojnë përmbushjen e qëllimeve kombëtare të arsimit parauniversitar, duke zbatuar rekomandimet e Këshillit të Evropës për mësimdhënien e historisë në shekullin XXI dhe duke forcuar qasjen e bazuar në kompetenca, me fokus në dy drejtime kryesore:

- Përditësime në aspektet përmbajtjesore të lëndës së historisë përmes temave të reja të veprimtarive praktike, perspektivave ndërdisiplinore dhe ndërlidhjes me aktualitetin shoqëror, mjedisor dhe teknologjik.
- Përditësime në aspektet pedagogjike dhe metodologjike me theks në qasjen e bazuar në kompetenca, mësimin aktiv, përfshirjen gjithëpërfshirëse dhe përdorimin e teknologjisë si mjet didaktik.

9.1 Përditësime në aspektet përmbajtjesore të lëndës së historisë

Në programin e lëndës së historisë për klasën e gjashtë janë bërë ndryshime të lehta në përmbajtje, të cilat përfshijnë:

1. Përditësimin e koncepteve kyçe historike për të harmonizuar terminologjinë me praktikën bashkëkohore të mësimdhënies dhe dokumentet ndërkombëtare të kurrikulës, duke ofruar një formulim më të qartë dhe funksional që lehtëson kuptimin dhe përdorimin e koncepteve nga nxënësit. Përfshirja e termave si “diversiteti” dhe “empatia historike” pasqyron zhvillimet e reja në didaktikën e historisë. Përditësimi i koncepteve kyçe historike, paraqitet në tabelën më poshtë:

Koncepte kyçe historike	
<i>Në versionin e mëparshëm</i>	<i>Në versionin e përditësuar</i>
Kuptimi kronologjik	Kronologjia
Ndryshimi dhe vazhdimësia	Ndryshimi dhe vazhdimësia

Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare	Diversiteti
-	Empatia historike
Rëndësia historike	Rëndësia historike

2. Zëvendësimin e termave “*para Krishtit*” dhe “*pas Krishtit*” me “*para erës sonë (p.e.s.)*” dhe “*pas erës sonë (e.s.)*” për një përdorim më neutral dhe gjithëpërfshirës.
3. Saktësime në emërtimin e tematikave, siç paraqiten më poshtë

KLASA 6	
Tematikat e mëparshme	Tematikat e përditësuara
Tematika 1. Qytetërimet botërore në Antikitet. Luginat lumore, djepi i qytetërimeve të hershme (mijëvjeçari IV – II pr. Krishtit)	Tematika 1. Qytetërimet e hershme në Antikitet (<i>mijëvjeçarët IV – II para erës sonë</i>)
Tematika 2. Qytetërimet në brigjet e deteve të Mesdheut (shekulli VII pr. K. – shekullin V ps. K.)	Tematika 2. Qytetërimet klasike në Mesdhe (<i>shek. VIII para erës sonë – shek. V të erës sonë</i>)
Tematika 3. Qytetërimet mesjetare në shekujt V – X	Tematika 3. Qytetërimet në mesjetën e hershme (<i>shek. V – X</i>)
Tematika 4. Zhvillimi i qytetërimeve mesjetare në shekujt X – XII	Tematika 4. Zhvillimet politike dhe shoqërore në mesjetën e mesme (<i>shek. XI – XIII</i>)
Tematika 5. Tiparet e sistemeve politike evropiane shekujt XII - XV	Tematika 5. Evropa në mesjetën e vonë (<i>shek. XIV – XV</i>)

4. Në rubrikat e njohurive, aftësive dhe të veprimtarive janë bërë disa saktësime sipas tematikave përkatëse, të cilat prezantohen më poshtë.

Tematika 1. Qytetërimet e hershme në Antikitet (mijëvjeçarët IV – II para erës sonë):

- Janë përditësuar temat e veprimtaritë praktike dhe rezultatet përkatëse të të nxënit, duke pasuruar përmbajtjen me elementë që theksojnë: zhvillimin e kompetencave historike, mendimit kritik dhe zgjidhjes së problemeve, integrimin e historisë së Shqipërisë, vlerësimin e identitetit kombëtar, patriotizmit, trashëgimisë kulturore dhe ndikimeve ndërkulturore; trajtimin e rreziqeve natyrore, pandemive, krizave ekonomike e politike, si dhe rolin e historisë në përballimin e sfidave bashkëkohore; rolin e zhvillimeve teknologjike në transformimin e jetës shoqërore dhe realitetit aktual.

Tematika 2. Qytetërimet klasike në Mesdhe (shek. VIII para erës sonë – shek. V të erës sonë):

- Është saktësuar formulimi i nën temës “Perandoria Romake” (*fundi i shekullit I para erës sonë – fundi i shekullit V pas erës sonë*)
- Është saktësuar formulimi i rezultatit “Tregon në hartë vendosjen dhe shtrirjen e qytetërimeve antike të mesdheut, qytetërimit fenikas dhe hebraik.”
- Janë shtuar konceptet kyçe: fenikas; hebraik, për të thelluar kuptimin e ndikimeve ndërkulturore në rajon.
- Janë përditësuar temat e veprimtarive praktike dhe rezultatet përkatëse të të nxënit, duke pasuruar përmbajtjen me elementë që theksojnë: trashëgiminë kulturore dhe identitetin historik; ndikimet ndërkulturore dhe rolin e demokracisë antike; sfidat historike dhe aktuale si krizat, migrimet dhe transformimet shoqërore; lidhjen ndërmjet arritjeve të qytetërimeve klasike dhe zhvillimeve teknologjike të sotme.

Tematika 3. Qytetërimet në mesjetën e hershme (shek. V – X):

- Janë saktësuar formulimet e nën temave “Organizimi i Perandorisë Bizantine” dhe “Qytetërimi arab dhe Evropa”.
- Është saktësuar formulimi i rezultatit “Vlerëson arritjet e qytetërimit arab në art, kulturë dhe shkencë dhe ndikimin e tij në Evropë”.
- Janë shtuar konceptet kyçe: krishterim i ritit perëndimor (katolicizëm); krishterim i ritit lindor (ortodoksi);
- Janë përditësuar temat e veprimtarive praktike dhe rezultatet e të nxënit.

Tematika 4. Zhvillimet politike dhe shoqërore në mesjetën e mesme (shek. XI – XIII):

- Janë përditësuar temat e veprimtarive praktike dhe rezultatet e tyre të të nxënit.

Tematika 5. Evropa në mesjetën e vonë (shek. XIV – XV):

- Janë saktësuar formulimet e nën temave: “Mbretëria e Anglisë dhe “Monarkia franceze”.

- Janë shtuar rezultatet e të nxënit: “Dallon ndryshimet ndërmjet monarkisë Franceze dhe angleze” dhe “Ndërton linjën e kohës për periudhën mesjetare”.
 - Janë saktësuar formulimet e rezultateve: “Përshkruan etapat e zhvillimit të mbretërisë franceze”; “Krahason tiparet e zhvillimit të artit dhe të kulturës në qytetërimin arab dhe atë perëndimor”; dhe “Njeh dhe vlerëson disa nga figurat historike që i përkasin kësaj tematike, si: Henri II, Henri VII, Mbreti Xhon, Uat Tajler, Eduardi i Anglisë, Huniadi, Mehmeti II, Llazari, Skënderbeu etj.”.
 - Janë përditësuar temat e veprimtarive praktike dhe rezultatet e tyre të të nxënit.
5. Janë përditësuar qëndrimet dhe vlerat.

9.2 Përditësimet në aspektin metodologjik

- Përditësimi i kompetencave kyçe dhe i rezultateve të të nxënit, të përshtatura për klasën e gjashtë.
- Përditësimi i rezultateve të të nxënit për konceptet kyçe dhe kompetencat historike të përshtatura për klasën e gjashtë.
- Përditësimi i temave ndërkurrikulare, me qëllim trajtimin e çështjeve prioritare përmes integritit të njohurive nga lëndë të ndryshme, duke përfshirë kështu mësimin gjithëpërfshirës dhe zhvillimin e aftësive të mendimit kritik dhe analizës nga perspektiva të ndryshme.
- Harmonizimi i metodologjisë me rekomandimet e Këshillit të Evropës për mësimdhënien e historisë në shekullin XXI.
- Ofrimi i një metodologjie më të përshtatshme dhe të balancuar në zhvillimin e kompetencave historike, zhvillimin e mendimit kritik, krijues dhe zgjidhjen problemore, duke përfshirë të nxënit e personalizuar, të nxënit socio-emocional, përdorimin e teknologjisë etj.
- Përfshirja e shembujve të veprimtarive për përmbushjen e RN-ve
- Përditësimi i vlerësimit të nxënit bazuar në nivelet e arritjes sipas rezultateve të të nxënit.
- Përditësimi i temave të veprimtarive praktike dhe i rezultateve përkatëse të të nxënit me elementë që theksojnë trashëgiminë kulturore dhe identitetin historik, ndikimet ndërkulturore dhe rolin e demokracisë në qytetërimet antike, sfidat historike dhe aktuale si krizat, migrimet dhe transformimet shoqërore, si dhe lidhjen ndërmjet arritjeve të qytetërimeve klasike dhe zhvillimeve teknologjike të sotme, duke nxitur zhvillimin e aftësive të mendimit kritik, mendimit krijues dhe zgjidhjes së problemeve.

- Nxitja e ndërgjegjësimit për diversitetin, bashkëjetesën dhe dialogun ndërkulturor si elemente themelore të edukimit për jetesën në një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe demokratike.
- Përqendrimi në përgatitjen e nxënësve për një qytetari aktive, kritike dhe të ndërgjegjshme në një botë dinamike dhe në ndryshim të vazhdueshëm, përmes përfshirjes së çështjeve dhe veprimtarive që trajtojnë:
 - ✓ identitetin kombëtar, patriotizmin, trashëgiminë kulturore dhe ndikimet ndërkulturore;
 - ✓ rreziqet natyrore, pandemitë, krizat ekonomike dhe politike, duke theksuar rolin e historisë në kuptimin dhe përballimin e sfidave bashkëkohore;
 - ✓ rolin e zhvillimeve teknologjike në transformimin e jetës shoqërore dhe realitetit bashkëkohor, si në të tashmen ashtu edhe në perspektivën ardhshme;
 - ✓ përshtatje të përmbajtjes dhe metodave për pakicat kombëtare, nxënësit me nevoja të veçanta, si dhe detyra të avancuara për nxënësit e talentuar.

Të gjitha ndryshimet synojnë të përmirësojnë qartësinë konceptuale, saktësinë historike dhe koherencën edukative, në përputhje me qëllimet formuese të lëndës.